


KONSULTIM ME PUBLIKUN

PROJEKTI HIDROCENTRALET “BATER, FRANKTH, SELITE”

Perroi Batres

Zona ne studim, Bashkia Mat



Ligji nr. 10440 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis”, i ndryshuar
Shtojca II, pika 3 (ë)
Instalime per prodhimin e energjise hidroelektrike

PASQYRA E LENDES

1. HYRJA

1.1 PERSHKRIMI I PROJEKTIT

1.2 KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

2. PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE SIPERFAQES KU PROPOZOHET TE ZBATOHET PROJEKTI

3. INFORMACION PER PRANINE E BURIMEVE UJORE

4. INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TE MUNDSHME, NEGATIVE, NE MJEDIS, TE PROJEKTIT

5. PERSHKRIMI PER SHKARKIMET E MUNDSHME NE MJEDIS

6. INFORMACION PER KOHEZGJATJEN E MUNDSHME TE NDIKIMEVE NEGATIVE TE IDENTIFIKUARA

7. TE DHENA PER SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPESINORE TE NDIKIMIT NEGATIV NE MJEDIS

8. REHABILITIMIT I MJEDISIT TE NDIKUAR

9. MASAT E MUNDSHME PER SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

10. NDIKIMET E MUNDSHME NE MJEDISIN NDERKUFITAR

1. HYRJA

1.1 PERSHKRIMI I PROJEKTIT

HEC Batra, HEC Selitë dhe HEC Frankth është pjesë perberese e skemes se shfrytezimit te perroit te Batres, kjo skeme është e perbere nga 3 hidrocentrale te emertuara perkatesisht HEC Selitë, HEC Frankth, HEC Batra.

HEC Batra ndodhet ne pjesen e poshteme te perroit te Batres dhe është i pari per nga renditja duke filluar nga kuota me e ulet e shfrytezimit te perroit te Batres, ky HEC perbehet nga nje veper marrje e cila ndodhet menjehere mbas godines se centralit te Hec-it Frankth, kuota e nivelit normal te vepres se marrjes është 303.00 m, baseni i presionit është vendosur ne kuote te nivelit te ujit 290.90 m, Godina e centralit shkarkon ne kuoten 159.80 m ndersa aksi i turbines ne godine është ne kuoten 161.00 m, kuota 161.00 sherben per llogaritjen e fuqise se instaluar te HEC-it.

Koordinatat e objekteve paraqiten si me poshte vijon:

Hec Selite (sistemi kordinativ Gauss-kruger)		
Aksi	X	Y
Vepra e marrjes	X=4409808.972	Y=4601712.816
Ndertesa e centralit	X=4411919.014	Y=4602887.458

Hec Selite (sistemi kordinativ KRGJSH)		
Aksi	X	Y
Vepra e marrjes	X=493099.941	Y=4600995.966
Ndertesa e centralit	X=495206.676	Y=4602217.954

Hec Frankth (sistemi kordinativ Gauss-kruger)		
Aksi	X	Y
Vepra e marrjes	X=4412059.424	Y=4602937.679
Ndertesa e centralit	X=4414014.313	Y=4603908.228

Hec Frankth (sistemi kordinativ KRGJSH)		
Aksi	X	Y
Vepra e marrjes	X=495357.176	Y=4602270.034
Ndertesa e centralit	X=497337.915	Y=4603252.573

Hec Bater (sistemi kordinativ Gauss-kruger)		
Aksi	X	Y
Vepra e marrjes	X=4414296.848	Y=4604242.641
Ndertesa e centralit	X=4418671.147	Y=4607856.211

Hec Bater (sistemi kordinativ KRGJSH)		
Aksi	X	Y
Vepra e marrjes	X=497571.184	Y=4603600.024
Ndertesa e centralit	X=501905.169	Y=4607263.692




Fig. Planvendosja e HEC Bata ne harte topografike

HEC Bata shfrytëzon ujrat e perroit te Batres menjehere mbas godine se centralit te HEC Frankth.

Ky hidrocentral do te jete i tipit me derivacion ku prurja pasi kapet me ane te vepres se marrjes te tipit me marrje anesore kalon ne zhavorr-kapes me pas kalon ne Dekantues ku pasi dekantohet kalon ne kanal in e derivacionit e me pas kalon ne basenin e presionit dhe duke u qetesuar ne basenin e presionit ajo kalon ne tubacionin e turbinave e perfundon duke u turbinuar e duke prodhuar energji ne godinen e centralit e cila nga ana e saj eshte vendosur ne nje tarrace te pershtatshme ne kuoten e shkarkimit 159.80 m .

Hydrocentrali Batra shfrytezon ujrën e rrjedhjes së poshtme të perroit të Batres me kuotë të nivelit normal në bjetin e sipërm në vepren e marrjes $\nabla N_{\text{nor}}^{\text{B.S}} = 303.00 \text{ m}$, dhe kuotë shkarkimi nga ndertesa e centralit në kushte normale të bjetit të poshtëm $\nabla N_{\text{nor}}^{\text{B.P}} = 159.80 \text{ m}$.

HEC Frankth ndodhet në pjesën e mesme të perroit të Batres dhe është i dyti për nga renditja duke filluar nga kuota më e ulët e shfrytëzimit të perroit të Batres, ky HEC përbehet nga një veper marrjeje e cila ndodhet menjëherë mbas godinës së centralit të Hec-it Frankth, kuota e nivelit normal të vepres së marrjes është 440.00 m, baseni i presionit është vendosur në kuotë të nivelit të ujit 435.80 m, Godina e centralit shkarkon në kuotën 304.50 m ndërsa aksi i turbinës në godinë është në kuotën 306.00 m, kuota 306.00 shërben për llogaritjen e fuqisë së instaluar të hec-it.




Fig. Planvendosja e HEC Frankth në hartë topografike

HEC Frankth shfrytezon ujrën e perroit të Batres menjëherë mbas godinës së centralit të HEC Frankth.

Ky hidrocentral do të jetë i tipit me derivacion ku prurja pasi kapet me anë të vepres së marrjes të tipit me marrjeje anësore kalon në zhavorr-kapes me pas kalon në Dekantues ku pasi dekantohet kalon në kanalin e derivacionit e me pas kalon në basenin e presionit dhe duke u qetesuar në basenin e presionit ajo kalon në tubacionin e turbinave e perfundon duke u turbinuar e duke prodhuar energji në

godinen e centralit e cila nga ana e saj eshte vendosur ne nje tarrace te pershtatshme ne kuoten e shkarkimit 304.50 m .

Hidrocentrali Frankth shfrytezon ujrat e rrjedhjes se mesme te perroit te Batres me kuote te nivelit normal ne bjeftin e siperm ne vepren e marrjes $\nabla N_{nor}^{B.S} = 440.00$ m, dhe kuote shkarkimi nga ndertesa e centralit ne kushte normale te bjefti te poshtem $\nabla N_{nor}^{B.P} = 304.50$ m.

HEC Selitë ndodhet ne pjesen e sipërme te perroit te Batres dhe eshte i treti per nga renditja duke filluar nga kuota me e ulet e shfrytezimit te perroit te Batres, ky HEC perbehet nga nje veper marrje e cila ndodhet nen uren e fshatit Selite, kuota e nivelit normal te vepres se marrjes eshte 649.00 m, baseni i presionit eshte vendosur ne kuote te nivelit te ujit 643.50 m, Godina e centralit shkarkon ne kuoten 442.10 m ndersa aksi i turbinës ne godine eshte ne kuoten 444.00 m, kuota 444.00 shërben per llogaritjen e fuqise se instaluar te HEC-it.




Fig. Planvendosja e HEC Selite ne harte topografike

HEC Selitë shfrytezon ujrat e perroit te Batres nen uren e fshatit Selite menjehere mbas bashkimit te dy proskave.

Ky hidrocentral do te jete i tipit me derivacion ku prurja pasi kapet me ane te vepres se marrjes te tipit me marrje anesore kalon ne zhavorr-kapes me pas kalon ne Dekantues ku pasi dekantohet kalon ne tubacionin e derivacionit me pas kalohet perroin me ane te nje sifoni dhe me kanal derivacioni prurja kalon ne basenin e presionit dhe duke u qetesuar ne basenin e presionit ajo kalon ne tubacionin e turbinave e perfundon duke u turbinuar e duke prodhuar energji ne godinen e centralit e cila nga ana e saj eshte vendosur ne nje tarrace te pershtatsheme ne kuoten e shkarkimit 442.10 m .

Hidrocentrali Selitë shfrytëzon ujrat e rrjedhjes se sipërme te perroit te Batres me kuote te nivelit normal ne bjefin e siperm ne vepren e marrjes $\nabla N_{\text{nor}}^{\text{B.S}} = 649.00 \text{ m}$, dhe kuote shkarkimi nga ndertesa e centralit ne kushte normale te bjefi te poshtem $\nabla N_{\text{nor}}^{\text{B.P}} = 442.10 \text{ m}$.

1.2 KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

Procesi i hartimit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM), ndihmon ne permiresimin e çdo lloj projekti ne respektimin dhe mbrojtjen maksimale te mjedisit te zones ku ai zbatohet.

Qellimi i VNM-se eshte qe te siguroje qe mjedisi ne zonen ku zbatohet projekti do te konsiderohet i lidhur me gjithë çështjet e tjera te rendesishme, ne çdo etape te tij.

Ky raport eshte hartuar bazuar ne legjislacionin mjedisor ne fuqi dhe ka per qellim te identifikojë, parashikojë dhe vleresojë gjithë ndikimet e mundshme ne menyre sistematike, te kuptueshme dhe objektive.

VNM-ja eshte vleresimi mjedisor ne nje proces vleresimesh (te mjedisit, planifikimit hapesinor, ndertimit, etj.) qe eventualisht mund te finalizohet me Lejen e Zhvillimit.

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis ne fakt i pergjigjet ne thelb ketyre pyetjeve kyç:

A. Si do te ishte mjedisi pa projektin? (per shembull Studimet Baze). Kjo do te identifikojë dhe pershkruajë gjendjen aktuale te burimeve dhe karakteristikat ekzistuese ne mjedisin qe mund te ndikohet nga projekti dhe se si keto do te zhvillohen ne mungese te projektit.

B. Çfare do t'i ndodhe ne mjedisit, si pasoje e projektit? (per shembull Parashikimi). Kjo do te pershkruajë mjedisin siç eshte pa projektin dhe se si ai do te ndryshojë si pasoje e projektit ne aspektin e burimeve mjedisore apo njerezve (receptoret) qe jane te ndikuar, natyren dhe shkallen e ndryshimit, shtrirjen e tij gjeografike dhe kohore.

C. A perben kjo nje shqetesim? (per shembull Vleresimi) Parashikimi i ndikimit nuk eshte i mjaftueshem.

D. Neseeshte i rendesishem a mund te bejme ndonje gje ne lidhje me te?(per shembull Zbutja). Se fundi, eshte e rendesishme te kuptohet se, ne qofte se ndikimi eshte i rendesishem, mund te behet diçka per teshmangur, reduktuar, korrigjuar apo kompensuar per te. Zhvilluesi i projektit mund t'i perfshije keto masa zbutese ne propozimet e projektit dhe autoriteti kompetent mund t'i perfshije kerkesat perkatese ne kushtet e lejes sedhene.

Ne menyre qe autoritetet kompetente dhe palete jashtme te interesuara te vendosin ne se projekti duhet te vazhdoje, eshte thelbësore qe informacioni mjedisor i dhenenga zhvilluesi ne Raportin e VNM-se, t'i pergjigjet ne menyre te qarte pyetjeve te mesiperme. Qellimi i studimeve te VNM eshte qe te gjenerojedhe paraqesekete informacion ne menyre te qarte, koherente dhe te sakte.

Idea e VNM-se eshte te siguroje informacion per vendim marresit dhe publikun mbi pasojat mjedisore te zhvillimeve te reja te propozuara. Per me teper ideja eshte qe te promovohet zhvillimi qe respekton mjedisin permes identifikimit te masave te duhura forcuese dhe zbutese.

Objektivi kryesor i VNM-se eshte te identifikojedhe ndikimet e mundshme negative mjedisore te projekteve te reja te zhvillimit. Brenda ketij qellimi, procesi i VNM-se kerkon qe:

- te konsiderohen alternativat per vendndodhjen dhe ndikimet mjedisore shoqeruese;
- te permiresohet plani mjedisor i propozimit;
- te sigurohet qe burimet jane perdorur si duhet dhe ne menyre efiçente;
- te identifikohen masat e duhura per zbutjen e ndikimeve te mundshme te propozimit;
- te vendosen kushtet per ndertimin; dhe
- te ndihmohet vendim marrja dhe informimi i publikut.

Procedura e VNM-se perfshin:

- a. procesin paraprak te VNM-se;
- b. procesin e thelluar te VNM-se.

Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM) shyrton kerkesat per vleresimin e ndikimit ne mjedis dhe ne fund te seciles procedure, paraprake apo te thelluar te VNM-se, merr Vendimin per VNM-ne paraprake, ndersa per VNM-ne e thelluar pergatit Deklaraten Mjedisore me rekomandimet perkatese dhe i'a degon Ministrise.

Ne perfundim vendim marrja konsiston ne:

- Vendim - leshuar nga AKM-ja ne perfundim te procedures paraprake te VNM-se
- Deklarate Mjedisore - leshuar nga Ministri ne perfundim te procedures se thelluar te VNM-se

Referuar ligjit nr. 10440/2011 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis”, te ndryshuar projekti i propozuar per hidrocentralin HeC “BATER” listohet ne Shtojcen II te ketij ligji ne piken 3 (ë) “Instalime per prodhimin e energjise hidroelektrike” dhe si rrjedhoje i nenshtrohet procedures paraprake te VNM-se.

Theksojme se gjate procedures paraprake te VNM-se, referuar VKM nr. 247, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”, Kreu I **nuk eshte e detyrim ligjor te behet Konsultim Paraprak me banoret e zones.** Perprara marrjes se Vendimit (sic detajohet me poshte) AKM-ja publikon aplikimin per VNM paraprake ne web te saj, ku komuniteti i interesuar mund te shpreh mendimin e tij.

Vendimi

Vendimi i AKM-se ne fund te procedures Paraprake te VNM-se percakton nese nje projekt i listuar ne Shtojcen II te Ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, ne fuqi, duhet apo jo t'i nenshtrohet procedures se thelluar te VNM-se. Nese AKM-ja vendos se projekti nuk duhet t'i nenshtrohet procedures se thelluar te VNM-se, ne vendimin e saj percakton arsyet dhe konsideratat kryesore ku eshte mbeshtetur mendimi, mendimin e institucioneve te konsultuara, pershkrimin sipas rastit, te masave kryesore qe duhen marre per te shmangur, reduktuar dhe nese eshte e mundur per te korrigjuar ndikimet negative te mundshme ne mjedis.

Deklarata Mjedisore

Rezultati perfundimtar i procedures se thelluar te VNM-se, eshte Deklarata Mjedisore, e cila mund te permbaje refuzimin ose miratimin me rekomandime per Autoritetin e Planifikimit per te vazhduar procesin ne baze te kushteve te specifikuara mjedisore.

Deklarata mjedisore sherben si dokument orientues per Autoritetin e Planifikimit dhe/ose çdo autoritet pergjegjes ne procesin e vendim marrjes, per nje leje zhvillimi apo per nje leje te caktuar per miratimin e nje projekti te listuar ne Shtojcat 1 dhe 2 te ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, ne fuqi.

Dokument i baze ku mbeshtetet procesi i VNM-se, eshte raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis, i cili ne varesi te ndikimeve te mundshme te projektit mund te jete:

- a. raport paraprak i VNM-se per projektet e shtojces II te ligjit nr. 10440, date 07.07.2011'Per vleresimin e ndikimit ne mjedis' te ndryshuar;
- b. raport i thelluar i VNM-se per projektet e shtojces I te ligjit nr. 10440, date 07.07.2011'Per vleresimin e ndikimit ne mjedis' te ndryshuar.

Baza ligjore

1. Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 'Për mbrojtjen e mjedisit', të ndryshuar;
2. Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011 'Për vlerësimin e ndikimit në mjedis', të ndryshuar;
3. Ligji nr.10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër"
4. Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura" ndryshuar me ligjin, Nr.9868, datë 4.2.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8906 datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura"
5. Ligji nr.10 253, datë 11.3.2010 "Për gjuetinë"
6. Ligji Nr. 9533, datë 15.5.2006 Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor"
7. Ligji Nr. 9791, datë 23.7.2007 Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor"
8. Ligji Nr. 15/2012, Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor"
9. Ligji Nr. 36/2013, Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor"
10. Ligji Nr. 38/2013 Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor të ndryshuar"
11. Ligji Nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor"
12. Ligji nr. 68/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar.
13. Ligji nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis"
14. VKM nr. 686, datë 29.07.2015 'Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis(VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore';
15. VKM nr. 247, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore"
16. Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011" Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar;

17. VKM nr. 575 date 24.06.2015 "Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte"
18. VKM nr.175, datë 19.1.2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve"
19. VKM nr. 371, datë 11.06.2014 "Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme"
20. VKM nr. 418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"
21. VKM nr. 229, datë 23. 04. 2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme"
22. VKM nr.519, datë 30.6.2010 "Parqet Natyror Rajonal"
23. Vendim Nr. 22, datë 9.1.2008 "Për caktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal"
24. Vendim Nr. 1354, datë 10.10.2008 "Për rregullat dhe procedurat qe ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor"
25. Vendim Nr. 396, datë 21.06.2006 "Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore"
26. VKM nr.897. datë 21.2.2011 "Miratimi i Rregullave për Shpalljen e Zonave të Vecanta të Ruajtjes"
27. VKM nr. 532, datë 05.10.2000 "Për miratimin e studimit "Strategjia dhe Plani i veprimtimit për biodiversitetin"
28. VKM nr. 676, datë 20.12.2002 "Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare"
29. VKM nr. 594, datë 10.09.2014 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit"
30. Vendimi Nr. 435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë"
31. VKM nr 352, datë 29.04.2015. "Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të".

Objekt i ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, eshte percaktimi i kerkesave, pergjegjesive, rregullave dhe procedurave per vleresimin e ndikimeve te rendesishme negative mjedisore te projekteve te propozuara, private ose publike.

Sipas ligjit Per Mbrojtjen e Mjedisit, vleresimi i ndikimit ne mjedis i nje projekti te propozuar zhvillimi eshte vleresimi i ndikimeve te rendesishme, te mundshme te asaj veprimtarie ne mjedis.

KONSULTIM ME PUBLIKUN

Gjate procesit te vleresimit te ndikimit ne mjedis, kryhen identifikimi, pershkrimi dhe vleresimi ne menyren e duhur i ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie, duke percaktuar efektet e mundshme te drejtperdrejta dhe jo te drejtperdrejta mbi token, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimen, shendetin e njeriut, floren dhe faunen, peizazhin natyror, pasurite materiale, trashegimine kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre te ndersjella.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis zbaton parimin e parandalimit qe ne fazen e hershme te planifikimit te projektit, me qellim shmangien apo minimizimin e efekteve negative ne mjedis, permes harmonizimit dhe pershtatjes se saj me kapacitetin bartes te mjedisit.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjese e pergatitjeve per planifikimin e nje projekti zhvillimi dhe para kerkimit te lejeve perkatese te zhvillimit.

Ligji per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, dhe aktet nenligjore qe rrjedhin prej tij, te parafruara plotesisht me Direktiven e bashkimit Evropian per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis ka per qellim te siguroje nje nivel te larte te mbrojtjes se mjedisit, permes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit te demeve ne mjedis, nga projekte te propozuara para miratimit te tyre per zhvillim dhe garantimin e nje procesi te hapur vendimmarrjeje, gjate identifikimit, pershkrimet dhe vleresimit te ndikimeve negative ne mjedis, ne menyren dhe kohen e duhur si dhe perfshirjen e te gjitha paleve te interesuara ne te.

Ky ligj zbatohet per projektet e propozuara, private apo publike, te cilat mund te shkaktojne ndikime te rendesishme negative, te drejtperdrejta ose jo, ne mjedis, si pasoje e madhesise, natyres apo vendndodhjes se tyre.

Kerkesa te pergjithshme per vleresimin e ndikimit ne mjedis te nje projekti:

- Vleresimi i ndikimit ne mjedis perfshin percaktimin, pershkrimin dhe vleresimin e ndikimeve te pritshme te drejtperdrejta e jo te drejtperdrejta mjedisore te zbatimit apo moszbatimit te projektit.
- Ndikimet mjedisore te projektit vleresohen ne lidhje me gjendjen e mjedisit ne territorin e prekur ne kohen e paraqitjes se raportit perkates per vleresimin e ndikimit ne mjedis te projektit.
- Vleresimi i ndikimit ne mjedis perfshin pergatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes se veprimtarise, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zones ne gjendjen e meparshme, nese nje detyrim i tille parashikohet me ligj. Vleresimi perfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundesine per aksidente.

- Vleresimi i projektit perfshin, gjithashtu, propozimin e masave te nevojshme per parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve te tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjate zbatimit te projektit, perfshire edhe vleresimin e efekteve te pritshme te masave te propozuara.

Aspektet me te rendesishme te procesit paraprak te VNM-se, jane konsultimet me palet e tjera dhe vendimi nese kerkohet nje VNM e thelluar.

VNM paraprak eshte faza e pare e procesit te VNM. Sipas Nenit 8 te ligjit te VNM qellimi i VNM Paraprak eshte te identifikojte propozimet qe kerkojne VNM te thelluar. VNM Paraprak perjashton nga procesi ato propozime (shumicen) qe nuk kane ndikime te rendesishme, ose pak, ndikime lehtesisht te kontrollueshme, dhe per te cilat VNM eshte e panevojshme. Ne vijim, Tabelat dhe Listat e Kontrollit do te ndihmojne ne procesin i cili vendos nese kerkohet VNM per nje projekt te vecante ose tip projekti.

Tre fazat kryesore e VNM Paraprak jane:

- **Paraqitja e kerkeses** dhe dokumentacionit shoqerues nga zhvilluesi ne Ministrine e Mjedisit, kontrolli administrativ paraprak i aplikimit nga Ministria e Mjedisit dhe percjellja e tyre nga Ministria ne Agjencine Kombetare te Mjedisit (AKM);
- Kontrolli teknik **paraprak** ibere nga AKM dhe **konsultimi** i AKM **me insitucionet e tjera** dhe **publikimi** i aplikimit;
- AKM njofton per **vendimin e marre**, nese projekti eshte apo jo e nevojshme ti nenshtrohet procedures se thelluar te VNM, Ministrine e Mjedisit (MM) dhe palet e perfshira ne proces, dhe publikon vendimin ne faqen e internetit te AKM.

Konventat dhe marrveshjet nderkombetare ne lidhje me procesin e VNM-se

Direktiva e Keshillit te BE-se 97/11/EC e cila modifikoi Direktiven 85/337/EEC mbi Vleresimin e Disa Projekteve Publike e Private, parashikon qe autoritetet kompetente te shteteve anetare te kerkojne kryerjen e nje vleresimi te ndikimitmjedisor (VNM) per projektet qe mund te rezultojne me ndikim domethenes ne mjedis. VNM duhet te pergatitet para miratimit te projektit, ne menyre qe vendimi per miratim te marre paraysh ndikimet e mundshme te projektit ne mjedis. Direktiva paraqet nje liste te projekteve qe kerkojne studimin e VNM ne te tera rastet (Shtojca 1) dhe nje liste te projekteve qe mund te kerkojne nje studim te permbledhur VNM (Shtojca 2), ne varesi te nje vleresimi per ndikimet e mundshme qe mund te rezultojne nga projekti i propozuar apo te kriterave kufizuese, te vendosura nga secili shtet anetar. Propozimi aktual konsiderohet si nje projekt i Shtojces 2.

KONSULTIM ME PUBLIKUN

Direktiva kërkon që “VNM të identifikojë, përshkruajë e vlerësojë në mënyrën e duhur ndikimet e drejtpërdrejta e indirekte të një projekti per:

- Qëniet njerëzore, floren dhe faunen;
- Token, ujin, klimen dhe peizazhin;
- Asetet materiale te trashëgimia kulturore; dhe
- Ndërveprimin midis faktorëve të lartpërmendur.

Informacioni tjetër qe percaktohet ne direktive qe duhet te përfshihen në studimin e VNM-se jepet në Shtojcën IV të Direktivës 97/11/EC dhe ajo përfshin:

- një përshkrim të projektit;
- një përvijim të alternativave kryesore të vendodhjes dhe te teknologjise te marra ne shqyrtim per projektin e propozuar;
- një përshkrim të aspekteve të mjedisit që mund të ndikohen me shume nga projekti e që lidhen me popullsinë, florën, faunën, tokën, ujin, faktorët klimatik, asetet materiale, pejsazhin e raportin reciprok mes faktorëve të lartpërmendur;
- një përshkrim të ndikimeve domethënëse të projektit që dalin në pah nga ekzistenca e vetë projektit, shfrytëzimi i burimeve natyrore, clirimi/shkarkimi i lëndëve ndotëse, krijimi i zhurmave dhe trajtimi i mbetjeve;
- një përshkrim i masave të parashikuara për parandalimin, uljen dhe aty ku është e mundur, mënjanimin e efekteve të dëmshme në mjedis; dhe
- një përmbledhje jo-teknike e informacionit të siguruar.

Direktiva 97/11/EC (amenduar nga Direktiva 2003/35/EC pas nënshkrimit të Konventës së Aarhus nga Komuniteti, më 25 Qershor 1998, mbi pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrje dhe akses në vendosjen e drejtësisë në çështjet mjedisore) gjithashtu parashikon konsultimin me publikun, në fazën e propozimit e mbledhjes së informacionit, për t'i dhënë publikut të interesuar mundësinë për të shprehur mendimin e tyre para marrjes së vendimit lidhur me zhvillimin e propozuar.

Shqipëria është anetare dhe ndjek detyrimet e konventave te meposhtme nderkombetare:

- Konventa e Bernit (CH) “Per mbrojtjen e flores dhe faunes se eger dhe mjedisin e saj natyror ne Evrope.”, miratuar me ane te ligjit nr 8690, me 2 Mars 1998;
- Konventa e Barcelones “Per mbrojtjen e mjedisit detar dhe ujqor te Mesdheut” dhe protokollet e saj;
- Konventa e Bonit “Mbi mbrojtjen e faunes se eger shtegtare”;

- Konventa e Vienes “Mbi kontrollin e kalimit kufitar te mbetjeve te rrezikshme dhe asgjesimin e tyre”, miratuar me ane te ligjit nr. 8216, me 13 Prill 1997;
- Konventa e Vienes “Per mbrojtjen e shtreses se Ozonit” dhe protokoli i Montrealit “Mbi substancat qe demtojne shtresen e Ozonit”;
- Konventa e Aarhusit “Mbi te drejten e publikut per t’u informuar, per pjesemarrje ne vendim-marrje dhe e drejta per t’iu drejtuar organeve te drejtesise per çeshtjet mjedisore”, miratuar me ligjin nr. 8672, me 26 Tetor 2000;
- Konventa “Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis ne kuadrin Nderkombetar”. Hyr ne fuqi ne 4 Tetor 1991;
- Konventa e Kombeve te Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike, Tetor 1994;
- Konventa e Kombeve te Bashkuara mbi Biodiversitetin, Janar 1994;
- Kombet e Bashkuara “Konventa kunder zgjerimit te shkretetirave ne vendet e thata, veçanerisht ne Afrike”. Hyrja ne fuqi me 27 Prill 2000.

2 PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE SIPERFAQES KU PROPOZOHET TE ZBATOHET PROJEKTI

Rajoni në të cilin ndodhet do të zhvillohet projekti ndertim dhe funksionim I HEC-Frankth kalon nëpër territorin e Bashkise Mat, I cili bën pjesë në prefekturën e qarkut Diber.



Flora dhe Fauna

a – Ekosistemet, habitatet dhe peisazhet ekzistuese

Zona e studiuar për ndertimin e Hidrocentralit të Batres është me peisazh të zakonshëm malor, dhe nuk gëzon status të vecantë mbrojtjeje përveçse i përket flores, faunës e habitateve të ndryshme. Habitatet ekzistuese natyrore e gjysëm natyrore në zonën e studjuar janë shumë të reduktuara në mobilim, dhe në shumicën e rasteve në degradim të avancuar.

Tipet kryesore të habitateve janë:

Flora

Dallohet diversiteti i lartë i cili mendohet të jetë rezultat i pozicionit gjeografik të Shqipërisë, e varet shumë nga topografia e klimës.

Kjo florë, veçse është e pasur në specie, tregon dhe nivelin e lartë të autoktonisë si brenda vendit ashtu dhe më gjërë rajonit.

Përmendim habitatet e mëposhtme si:

- Shkurret mesdhetare dhe pyjet.
- Kullotat.

- Zonat e mbrojtura të Parkut Lures, se Qaf Shtames apo Mait te Dajtit jane teper larg nga zona ne studim ku do te zbatohet projekti.

Ne kufijte jashte zones se projektit nuk ka toka bujqesore dhe breza te gjelberuar te cilet nuk do te preken nga veprimtaria e shfrytezimit.

Fauna

Perfaqesohet nga gjitaret, zogjte, reptilet,.Ne zonen në studim takohen rreth 30 specie gjitaresh, 85 specie zogjsh,17 specie reptilesh dhe nuk ka status të konservimit natyror.

Tokat, kategoria e tokes, gjeologjia dhe gjeomorfologjia

Shkëmbi perbehet nga karbonat kalciumi dhe dolomit. Perberja petrografike e shkëmbit rezulton te jete:

Gëlqeror të facies pelagjike,me structure copezore , kokrizore e rrallë structure massive. Ato janë pllakorë e masive me trashësi 1-5 m deri 10m.

Gëlqerorët qe janë object i shfrytëzimit të gurit kanë trashësi mbi 1m mbulese e cila është rezultat I erozionit të zgjatur.

Treguesit fiziko – mekanik te materialit karbonatik jane:

Pesha volumore –2518kg/m³

Pesha specifike –2,91gr/cm³


Rezistenca në shtypje - 603-768 kg/cm²

Ûjethithja - 1,25 %

Siperfaqja qe do te zihet nga ndertimi I vepres se HEC-Bater nuk perfaqeson toka are.

Gjeologjikisht objekti lidhet me depozitimet pelagjikee detare karbonatore te moshes Kretë-Paleocen-. Masivi karbonatik i Klosit bën pjesë në Albanidet e Brendeshme.

Pra, projekti konsiderohetqe nuk shkakton asnje lloj demtimi ne ambient. Megjithate projekti parashikon qe materiali i paperdorshem te hidhet ne përfundim të shfrytëzimit në karrierën e shfrytëzuar.



Harta e tipeve te tokave


Ajri, faktoret klimatike, cilesia e ajrit

Objekti i kerkuar per shfrytezim ndodhet ne bashkine Mat me klime tipike mesdhetare malore e nenzones lindore.

Temperaturat mesatare vjetore jane 12,60C. Temperatura e muajit me te ftohte, Janarit eshte -6 0 C, kurse e Korrikut, si muaji i nxehte 26 – 360C.

Sasia e rreshjeve luhartet nga 2215mm/vit mesatarja ne vit deri ne 1200 mm ne raste te vecanta. Sezoni kryesor i rreshjeve eshte Tetor-Shkurt me rreth 210mm cdo muaj.

- Lageshtia mesatare vjetore 68-74%
- Drejtimi kryesor i eres eshte veri-perendim, jug-lindje.
- Shpejtesia me e larte e eres luhartet 50-60 m/sek



Trashegimia arkitektonike dhe historike.


Ne afersi te zones qe do te shfrytezohet nuk ka zona turistike, arkeologjike apo zona te mbrojtura per pasoje dhe veprimtaria e nxjerrjes se mineralit nuk do te kete ndonje ndikim ne kete fushe.

Pejsazi dhe Topografia

Vete lloji i veprimtarise dhe vendi i zgjedhur per shfrytezim e burimit uhor te perroit te Bratesper prodhimin e energjise nuk jane te ekspozuara. Zona ndodhet larg zonave rurale e aq me teper zonave urbane


Zona nuk prek as pejsazhin e malit.


Shfrytezimi në masiv realizohet ne diferenca te vogla lartesis midis pikave ekstreme (lindje-perëndim) me kuota nga +580m ne +647 m.



Harta e relievit

Copetimi horizontal i relievit në këtë zonë është i madh dhe shume i madh ne terrigjenet e vjetër dhe te rinj dhe i vogel dhe shumë i vogel në gelqeroret. Energjia e relievit është mesatare ne shkembinjte terrigjene ne pjesën qendrore dhe ne rrethin ata shkojnë ne vlerat maksimale 400-500m/km². Në këtë malësi takohen tipa të relievit strukturoro-eroziv erozivo-dedunues, karstik, akullnajor. Relievi strukturor eroziv takohet ne gjithe zonën, edhe relievi karstik është shumë i përhapur. Këtu duhet theksuar se kanë ndikuar klima me reshjet dhe me larmine e saj e ndryshymet e theksuara në parametra. Gjejmë forma te larmishme si: ulluqe, brazda, gishtezi, dalina, fusha dhe lugje e lugina karstika gjejmë edhe forma nën tokesore si shpella, boshlleqe e lugina nen tokesore, te ndryshme. Relievi akullnajor ka shtrirje te e gjejmë vetëm ne pjesë te larta si majat e maleve që kanë përberje gëlqeroresh. Gjejmë edhe lëndina me peisazhe piktoreske si fusha e Korabit, bjeshkët e Shehut qe janë të ralla për nga vlerat ekonomike.





3 INFORMACION PER PRANINE E BURIMEVE UJORE

Sistemi i gjere hidrologjik i Shqiperise perfshin 11 lumenj kryesore me 152 dege dhe perrenj te medhenj. Lumenjte kryesor nga veriu ne jug jane:

- Lumi Drin me dy deget e tij: Drinin e Bardhe dhe Drinin e Zi;
- Lumi Mat me degen kryesore te tij: Lumin Fan;
- Lumi Ishem;
- Lumi Erzen;
- Lumi Shkumbin;
- Lumi Seman me dy deget e tij ne rrjedhen e siperme: Lumin Devoll dhe Lumin Osum;
- Lumi Vjosa dhe dy deget e tij kryesore : Lumi Drinos dhe Lumi Shushica;
- Lumi Bistrica.

Zona ku do te ndertohen HEC Batra, HEC Selitë dhe HEC Frankth mbi perroin e Batres karakterizohet nga një rrjet i pasur burimesh ujore. Ushqimi kryesor i këtij rrjeti janë kryesisht reshjet dhe burimet e fuqishme karstike.

Trupi më i madh ujqor që përshkon zonën në studim është lumi i Matit. Lumi i Matit buron nga mali i Kaptinës së Martaneshit. Në gjatësinë e tij prej 97 km janë ngritur dy hidrocentrale. Prurjet mesatare vjetore 103 m³/sek.

Gjithashtu zona nëpër të cilën kalon segmenti rrugor ndërpritet nga një rrjet i dendur përrenjsh, ndër të cilët veçohen përroi i Zmajes, i Germashit, etj.

Kjo zone I perket basenit ujqor te Matit.

Baseni i Lumit Mat shtrihet ne pjesën veriore të rajonit malor qendror të Shqipërisë. Lumi është 115 km i gjatë dhe qarku i basenit lumor mbulon një sipërfaqe prej 2993 km². Ka afërsisht 134000 banorë, të shpërndarë nëpër bashkitë e Mirditës, Lezhës dhe Kurbinit dhe një pjesë të vogël të bashkive të Matit (Qarku Kukës) dhe bashkia e Fushë Arrëz dhe Pukës (Qarku Shkodër). Duhet të theksohet se kufijtë e Basenit të Matit nuk ndjekin ekzaktesisht kufijtë administrativ të Qarqeve për shkak të arsyeve hidrologjike dhe është akoma e pa qartë se ku ndodhet kufiri ekzakt i qarkut të Basenit të Lumit Drin.

Burimi i Lumit Mat është afër Martaneshit, në qarkun e Bulqizës, veri-perëndim përmes qyteteve Klos dhe Burrel. Rreth 10 km në rrjedhën e poshtme (*downstream*) nga Burreli lumi rrjedh në një rezervuar të madh, Liqeni Ulëz. Pasi kalon në një digë hidroelektrike, ai rrjedh në një rezervuar tjetër të vogël, Liqeni Shkopet dhe formon një lëndinë të ngushtë mes përmes vargmalit që ndan qarkun e Matit nga rrafshinat bregdetare. Sistemi i lumit të Matit arrin Detin Adriatik në Perëndim afër Fushë Kuqit, ndërmjet qytetit të Lezhës dhe Laçit nëpërmjet një kompleksi ujërash kalimtare dhe rrafshnalta bregdetare të kanalizuar duke përfshirë plazhe, duna dhe ligatina (këneta), të cilat janë kryesisht këneta me kripë dhe laguna.

Baseni i Lumit Mat është formuar nga dy degë, Lumi Mat dhe Lumi Fan. Lumi Fan e ka origjinën nga veri lindja e basenit, ndërsa vetë Mati rrjedh në jug lindje të basenit. Lumi i matit është 115 km i gjatë, dhe ujërat e burimit (që rrjedhin afër burimit/*headwater*) janë një burim që ndodhen në Malin Kaptina, afër Krastës. Lumi Matit rrjedh në një rezervuar të madh, Liqeni i Ulëz, nëpërmjet një dige hidroelektrike dhe në një rezervuar tjetër të vogël, Liqeni Shkopet përpara se të hyjë në rrafshnaltë dhe derdhet në Detin Adriatik afër Lezhës. Lumi Fan e ka origjinën nga dy degë, Fani i Vogël dhe Fani i Madh. Fani i Madh ka një zonë ujëmbledhëse rreth 540 km² dhe është afërsisht 77 km i gjatë, ku lëndina e Fanit të madh është rreth 60 km e gjatë. Të dy lumenjtë takohen/bashkohen afër Rrëshenit. Ka nëntë nën-basese brenda Basenit të Lumit Mat, me 6 stacione monitorimi hidrometrike. Stacionet e monitorimit ndodhen në pikën më të ulët të lartësisë. Nëntë nën-basenet janë emërtuar sipas degëve kryesore të lumit brenda nën-basenit. Qarku i Lezhës është i vetmi qark që shtrihet plotësisht në Basenin e Lumit Mat dhe ka një popullsi prej 134027. Aktivitetet kryesore ekonomike janë administrata publike, shitjet me shumicë dhe me pakicë, transportimi dhe magazinimi, aktivitete të shërbimit të akomodimit dhe ushqimit të cilat kanë numrin më të madh të të punësuarve brenda Qarkut. Për femrat administrata publike është punësimi më i rëndësishëm, ndjekur nga bujqësia, pylltaria dhe peshkimi, ndërsa për meshkujt tregtia me shumicë dhe me pakicë, transportimi dhe magazinimi, aktivitete të shërbimit të akomodimit dhe ushqimit në sektorët e parë ekonomik të ndjekur nga bujqësia, pylltaria dhe peshkimi.



Harta hidrologjike e zones ne studim

4 INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TE MUNDSHME, NEGATIVE, NE MJEDIS, TEPROJEKTIT

Metodika e identifikimit te ndikimeve te mundshme ne mjedis

Çdo veprimtari e re qe zhvillohet ne mjedis shoqerohet me pasoja dhe ndikime qe jane pjese e kompromisit qe shoqeria jone ka zgjedhur per t'u zhvilluar. Vleresimi i ndikimeve te mundshme ne mjedis si pasoje e zbatimit te projektit te propozuar eshte bere gjykuar mbi faktoret qe lidhen me natyren e veprimtarise, teknologjine e perdorur, menyren e funksionimit, sasine e energjise qe do te prodhohet, lendet e para te perdorura dhe mbetjet e gjenerura, te gjitha nen kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedis eshte analizuar sipas fazave te veprimtarise si me poshte:

- Ne fazen pergatitore/instalimeve/ndertimit te veprave inxhinjerike,
- Ne fazen e funksionimit te hidrocentralit dhe prodhimit te energjise elektrike.

Çdo faze e zbatimit te projektit pervec ndikimeve te pergjithshme dhe te perbashketa ka edhe ato specifike qe varen nga faktoret qe i shkaktone si p.sh. natyra e proceseve etj.

Eshte e rendesishme te kuptohet natyra e ketyre proceseve dhe forma e shfaqjes se tyre, direkte dhe indirekte, per te vleresuar drejt ndikimet e çdo veprimtarie qe perdor burimet natyrore. Sipas natyres ndikimet klasifikohen ne dy grupe te medha:

- Ndikime te kthyeshme,
- Ndikime te pakthyeshme.

Te dy llojet e ndikimeve mund te minimizohen ne terma relative ku qellimi kryesor eshte mbajtja e ndikimit brenda siperfaqes se çdo objekti dhe krijimi i kushteve natyrore per te siguruar riaktivizim te proceseve komplekse te natyres dhe rigjenerim te biodiversitetit.

Vete natyra e aktivitetit te propozuar dikton ndikime dhe efekte te perhershme ose ndikime mbetese ne karakterin e mjedisit te sapokrijuar pergjate gjithe teresise se tij, per zbutjen e te cilave propozohen masa konkrete.

Vleresimi i ndikimeve ne fazen e pergatitjes dhe ndertimit te veprave inxhinjerike

Paraprakisht theksojme se HEC-Bater nuk ka dhe nuk do te kete ndikime te konsiderueshme ne mjedis, pasi ato do te ndertohenku nderhyrjet ne terren nuk do te jene shume te medha.

KONSULTIM ME PUBLIKUN

Bazuar ne operacionet kryesore te punes per ndertimin e komponenteve inxhinierike te HEC-Bater, ne menyre te pergjithshme do te veqonim keto ndikime negative te pritshme ne mjedis:

- Ndryshim i destinacionit te perdorimit te tokes ne siperfaqet ku do te ndertohen veprat inxhinierike;
- Shqetesim i shtreses se tokes (ngjeshje) dhe premisa per erozion nga germimet dhe punimet e ndertimit te komponenteve te HC-ve; Prerje e bimesise dhe vegjetacionit ne siperfaqet ku do te ndertohen komponentet inxhinierike si ndertesat e centraleve, hyrjet dhe daljet e tuneleve, basenetei presionit dhe rruget e aksesit;
- Gjenerim i ujrave te ndotur (turbullira) gjate punimeve te ndertimit te veprave;
- Zhurma nga makinerite dhe veprimtaria ndertimore ne pergjithesi;
- Emetim pluhuri si rezultat i punimeve te germimit.

Me analitikesht ndikimet e mundshme per receptoret apo perberesit e natyres/mjedisit jepen ne tabelen e meposhtme, ku ne planin vertikal pershkruhen operacionet ne kuader te zbatimit te projektit dhe ne ate horizontal pasoja e operacionit ne mjedis.

Lloji i aktivitetit qeshte burim ndikimi	Natyra e ndikimit ne mjedis
Pershtatja e siperfaqeve te nevojshme ne te cilat do te ndertohen komponentet inxhinierike ku perfshihen edhe sheshet e rruget e sherbimit	<ul style="list-style-type: none">– Ndryshim i destinacionit te perdorimit te tokes;– Shqetesim i shtreses se tokes;– Demtim i flores, kryesisht shkurre por edhe elemente te pyllit si disa drure pishe, gjate pastrimit ne siperfaqet ku do te kryhen ndertime;– Ndryshime ne pejsazh dhe topografine e siperfaqes ku do te punohet;– Gjenerim i masave te dherave dhe materiali drusor.
Punime germimi per hapjen e themeleve te godines se HEC, vepres se marrjes, tuneleve dhe basenit te presionit	<ul style="list-style-type: none">– Do te gjenerohet nje mase shkembore (shih paragrafin pasardhes), nje pjese e te ciles do te perdoret gjate operacioneve ndertimore (godine, mbushje kanali, shtrim rruge etj.)– Demtim i struktures se tokes dhe cilesive fizike te saj;– Erozion ne kohe me reshje ne siperfaqet ku do te zhvillohen punimet;– Rritje e lendes se ngurte ne ujerat siperfaqesore dhe rrjedhimisht ne trupat ujore ku ata derdhen si pasoje e

KONSULTIM ME PUBLIKUN

	<p>shpelarjes se siperfaqeve te tokes se germuar (ne kohe me reshje);</p> <ul style="list-style-type: none">– Gjenerim pluhuri ne ajer, veçanerisht nese operacionet e ndertimit do te kryhen gjate stines se thate. Kjo sasi pluhuri do te ndikojë kryesisht mbi bimesine ne afersi te zonave ku do te kryhen punime ndertimi, pasi qendrat e banuara jane larg komponimeve inxhinierike;– Emetim i zhurmave mbi nivelet normale per shkak te punes se makinerive qe do te perdoren per germim, te cilat do te shkaktoje shqetesim kryesisht tek ndertuesit dhe bota shtazore;– Po keshtu vlera te caktuara minimale vibracioni do te prekin disa lloje floristike qe gjenden ne zone dhe ne afersi te saj;– Ndryshime ne pejsazhin dhe topografine e zones.
Ne projekt parashikohet hapja e shesheve dhe rrugeve te sherbimit	<ul style="list-style-type: none">– Operacionet e punes per sistemimin e e ketyre siperfaqeve do te shoqerohen me te njejtat ndikime ne mjedis si edhe punimet e tjera te ndertimit (te pershkuara me lart),
Qarkullimi i automjeteve dhe perdorimi i makinerive te tjera te nevojshme per operacionet e ndertimit.	<ul style="list-style-type: none">– Gjenerim pluhuri pasi jo te gjitha rruget qe do te perdoren gjate ndertimit te komponenteve inxhinierike jane te asfaltuara;– Ndotje e tokes dhe ujrave si pasoje e avarive dhe defekteve te ndryshme te mekanikes;– Prezenca e rrezikut te aksidentimit te kafsheve, kryesisht reptileve.
Aktiviteti njerezor gjate kryerjes se punimeve	<ul style="list-style-type: none">– Gjenerim i mbetjeve te ambalazhit si kartona, bidona, thase çimento dhe qese plastike.

Vleresimi i ndikimeve ne fazen e funksionimit

Ndikimet me te rendesishme ne mjedis qe evidentohen ne fazen e shfrytezimit te veprave HEC Batra, HEC Selitë dhe HEC Frankth jane:


1. Modifikim i ekosistemit te perroit te Batres. Zonat qe do te preken nga ky ndikim, i cili eshte nje ndikim afatgjate, perbejne edhe te ashtuquajturat zona te stresit hidrologjik;
2. Ndikime ne ekosistemet ujore, llojet peshkore dhe gjallesat e tjera.

Menaxhimi i sasise se ujrave qe do te shfrytezohen

Shfrytezimi i ujrave te lumit perroit te Batres mund te ndikojë minimalisht ne prurjen e ujrave te perroit. Ne projekt jane parashikur masat e nevojshme per parandalimin dhe minimizimin e ketyre ndikimeve.

Vlerat e kurbes se qendrueshmerise se prurjeve ditore ne aksin e vepres se marjes se HEC Bater, per vitin mesatar 50% siguri

Ditet	Q=50%
363.6	0.059
360.8	0.074
346.8	0.099
297.4	0.2178
255.9	0.363
231.7	0.5082
207.2	0.726
175.1	1.0175
150.5	1.276
135.1	1.452
116.1	1.622
99.9	1.74
68.6	2.31
35.8	3.3
11	4.95
1.2	8.25
0.1	13.2
0	19.8



Si kriter per percaktimin e prurjes llogaritese eshte konsideruar, prurja qe sigurohet ne te pakten 68 dite gjate nje viti. Nga ana tjetere eshte llogaritur shkalla e shfrytezimit te rrjedhjes vjetore duke e krahasuar me shkallen e shfrytezimit te kesaj rrjedhjeje ne veprat e ketij lloji nga pervoja Europiane qe lekundet ne kufijte (70-90)% te saj.

Per te percaktuar prurjen llogaritese te HEC-it eshte e detyrueshme te percaktohet prurja e nevojshme per nevoja ambientale te sistemit poshte vepres se marrjes. Kjo prurje eshte llogaritur me nje nga normat e publikuara nga ministria e mjedisit percaktuar te jete sa Q_{355} , ku $Q_{355}=0.08 \text{ m}^3/\text{s}$.

Nga tabela e vlerave te qendrueshmerise se prurjeve per vitin mesatar prurja qe zgjat te pakten 68 dite eshte rreth $2.31 \text{ m}^3/\text{sek}$ e cila merret si prurje llogaritese e HEC-it duke i zbritur prurjen ambientale $0.08 \text{ m}^3/\text{sek}$.

Si konkluzion, Prurja Llogaritese e pranuar per permasimin dhe llogaritjen Hidrocentralit Bater eshte pranuar **$2.2 \text{ m}^3/\text{sek}$**

Qendrueshmeria e prurjeve ditore per vitin mesatare me 50% siguri qe kalojne ne turbine (m³/s).

HEC - Bater

Ditet	Prurja llogaritese
363.6	0
360.8	0
346.8	0
297.4	0
255.9	0.283
231.7	0.4282
207.2	0.646
175.1	0.9375
150.5	1.196
135.1	1.372
116.1	1.542
99.9	1.66
68.6	2.2
35.8	2.2
11	2.2
1.2	2.2
0.1	2.2
0	2.2

Volumi i rrjedhjes vjetore qe shfrytezohet ne aksin e veprave te marrjes eshte 28,812,965.76 m³.

Shkalla e shfrytezimit te rrjedhjes ne aksin e perroit = 77.7%.

Siç rezulton nga tabela e mesiperme prurja llogaritese vjetore me te cilen shfrytezohet 77.7 % e rrjedhjes vjetore eshte 2.2 m³/sek. Si eshte theksuar me siper kjo eshte prurja llogaritese qe kalon ne turbine, pra pasi eshte zbritur prurja ambientale e percaktuar sipas kriterëve te vendosura nga ministria e mjedisit.

Perdorimi i analizave tekniko-ekonomike qe konsistojne ne krahasimin e kostove te energjise vjetore te perfituar perkundrejt kostove shtese per mbi-permasimin e veprave per shkak te pranimit ne vlera te larta te prurjes llogaritese kane rezultuar ne perfundimin qe efekti i rritjes se kosos per mbi-permasimin e veprave eshte pak i ndjeshem kundrejt kosos se energjise vjetore te perfituar. Si rezultat kemi pranuar si Prurje llogaritese ate qe ne nje vit rrjedh per te pakten 68 dite ne vitin mesatar duke zbritur prurjen mbetese ose ambientale.

Si konkluzion, Prurja Llogaritese e pranuar per permasimin dhe llogaritjet e te gjitha veprave te Hidrocentralit Bater eshte pranuar **2.2 m³/sek.**

- Vepra e marrjes e HEC Batra do te ndertohet menjehere pas godines se centralit te HEC Frankth duke respektuar kuoten e shkarkimit nga kjo godine per te mos ndikuar ne punen e saje gjate plotave, duke respektuar kuoten e shkarkimit te godines se HEC Frankth, vepra eshte vendosur te behet me kuote te shtratit te perroit afersisht $\nabla=296.00$ m, kuote te nivelit normal te ujit $\nabla N_{\text{nor}}^{\text{B.S}}=303.00$ m dhe kuote te nivelit maksimal kur kalon plota $\nabla N_{\text{max}}^{\text{B.S}}=304.60$ e cila i korespondon nivelit normal te shkarkimit nga godina e centralit te HEC Frankth.

Vepra e marrjes eshte vendosur te jete nje dige nivel-ngritese rreth 8.30 m e larte e pajisur me nje vrime anesore dhe nje front kaperderdhes, te afte per te shkarkuar prurjen maksimale me 1% siguri te llogaritur ne aksin e saj.

Zgjedhja e tipit te vepres se marrjes te HEC-it, kategorizimi i saj, dhe menyra e kapjes se prurjeve.

Per zgjedhjen e tipit te vepres se marrjes jane bere krahasimet midis

- a. vepres se marrjes te tipit me marrje anesore
- b. vepres se marrjes tiroleze.

Argumentim:

- a. vepra e tipit me marrje anesore perdoret ne rastet kur perroi por vecanerisht vendi ku do te vendoset vepra e marrjes ka pjerresi me te vogel se 10%.
- b. vepra e marrjes tiroleze prdoret ne rastet kur perroi eshte me pjerresi me te madhe se 10%.

Duke studiuar perroin dhe vendin ku do te ndertohet vepra e marrjes se HEC Bater kemi vendosur te **perdorim vepren e tipit me marrje anesore** sepse shtrati i perroit ne kete seksion ka pjerresi me te vogel se 10%, menyra e marrjes se prurjes me ane te kesaj vepre eshte duke hapur nje vrime me permasa $b \times h=(400 \times 50)$ cm ne murin e djathte te vepres se marrjes sic tregohet ne vizatimet perkatese te vepres se marrjes.

- Percaktimi i kuotave te ujit per regjimin normal dhe te jashtezkonshem ne anen e siperme.

Kuota e ujit per regjimin normal dhe ate te jashtezakonshem percaktohet duke marre parasysh shkarkimin e hec-it me siper, diga eshte vendosur te behet 8.3 m e larte me kuote te nivelit normal prej $\nabla N_{\text{nor}}^{\text{B.S}} = 303.00$ m, dhe per shkarkimin e prurjes katastrofike ne kuoten 304.60 m duke krijuar nje front kaperderdhes me gjatesi te frontit **L=25 m** dhe lartesi uji **H=1.5 m** i cili shkarkon prurjen me 1% siguri **Q_{1%}=65.8 m³/s**.

- Llogaritja e vrimes per kapjen e prurjes llogaritese.

Llogaritjet e vrimes per kapjen e prurjes llogaritese konsistojne ne llogaritjen e vrimes anesor per kapjen e prurjes llogaritese.

1. Gjatesia e vrimes
2. Lartesia e vrimes
3. Llogaritjet e vrimes per regjimin me presion (sasia e ujit qe hyn ne vrimen anesor kur kalon prurja maksimale).

Nga llogaritjet e kryera rezultoi qe vrima ansore eshte dimensionuar per nje prurje 2.4 m³/s, me te madhe se prurja llogaritese 2.2 m³/s kjo shtese prej 0.2 m³/s do te sherbeje per shpelarjen e aluvioneve te zhavorrkapesit dhe dekantusit, pra gjate shpelarjes HEC-i do te punoje normalisht me prurjen llogaritese, kjo sigurisht vlen ne perjudhen kur prurja e perroit eshte me e madhe se prurja llogaritese 2.2 m³/s.

Llogaritja e aftesise percjelles per kete regjim kryhet per te percaktuar prurjen maksimale qe hyn ne vrimen ansore, kur mbi digen kaperderdhes kalon prurja maksimale me 1% siguri **Q_{1%}=65.8 m³/s**.

Perfundimisht nga llogaritjet e kryera nga inxhinjeret rezulton qe prurja maksimale qe do te futet ne vrimen ansore eshte **Q = 6.51 m³** kur mbi digen kaperderdhes kalon prurja me 1% siguri. Kjo prurje do te shkarkohet ne dekantues, pra kaperderdhesi qe do te vendoset ne dekantues do te dimensionohet me kete prurje.

- Vepra e kapjes se zhavoreve, llogaritjet hidraulike dhe permasimi ne plan dhe lartesi i saj.

Pervec ndertimit te dekantuesit, ndertohet dhe nje zhavorkapes fill mbas vepres se marrjes per te mbajtur aluvionet me dimensione te medha te cilat futen ne vrimen ansore dhe nese do te kalonin ne dekantues do te ndikonin ne punen normale te dekantusit pasi do ta mbushnin shume shpejt ate. Diametri i grimcave qe do te dekantohen ne zhavor kapes eshte me i vogel ose 50 mm. Ndertimi i ketij zhavorkapsi lehteson punen e dekantuesit.

Eshte pranuar qe zhavorrkapesi te kete permasa afersisht 14.5 m i gjate dhe 3.7 m i gjere sic tregohet ne vizatimet perkatese.

- Vepra e kapjes se aluvioneve, percaktimi i numrit te dhomave dhe i diametrit te grimcave per dekantim, llogaritjet hidraulike dhe permasimi ne plan dhe lartesi i dekantuesit.

Dekantuesi vendoset fill mbas zhavorrkapesit dhe eshte ne nje konstruksion me te. Pozicioni dhe aksi i Dekantuesit eshte zgjedhur duke marre parasysh kriteret e meposhtme:

1. Te disponoje siperfaqen e duhur per vendosjen e dhomave dhe elementeve te tjere rakordues dhe shpelarje/shkarkimit.
2. Te siguroje nje hyrje te ujit ne kanalin e derivacionit te qete dhe ne vije te drejte
3. Te jete i mbrojtur nga shkarkimet e plotave ne digen kaperderdhese

Dekantuesi eshte zgjedhur te jete me nje dhoma, i pajisur me nje shkarkues automatik i cili eshte vendosur ne fund te dekantuesit ne krahun e djathte te tij dhe shkarkon ne perrua sebashku me materialin e ngurte te dekantuar qe del nga dhoma e dekantuesit me ane te nje galerie e cila ne fund eshte e paisur me nje saraqineske manovrimi me diameter $D=600\text{mm}$. Permasimi i dekantuesit eshte bere bazuar ne arsyetimet, formulat dhe llogaritjet qe jepen si me poshte.

Llogaritja hidraulike e dekantuesit

Dekantuesi është një vepër hidroteknike që shërben për mbajtjen e aluvioneve me një diametër të caktuar që këto të mos kalojnë në pjesën transportuese të ujit dhe të shkojnë në tubacionin e turbinave nga ku mund të dëmtojnë turbinat.

Kemi shqyrtuar dy lloje dekantuesish: me shplarje periodike dhe me shplarje të përhershme.

Duke qenë se në këtë projekt ne nuk kemi të dhëna mbi sasinë reale të prurjes te ngurte dhe pezull që sjell perroi, por duke e krahasuar me sasine e prurjes se ngurte, dhe me llojin dhe perberjen granulometrike te materjalit te kesaj prurje te ngurte te vrojtuar ne shtratin dhe brigjet e perroit te Batres, grupi projektimit mendon si me të pershtatshme të zgjedhim si dekantues atë me shplarje periodike dhe mënyra e shplarjes do të jetë me metodën hidraulike.

Parimi i punës i këtij dekantuesi është krijimi i një vëllimi të vdekur ku depozitohen aluvionet që dekantohen, dhe me metodën e shplarjes me ujë bëhet largimi i këtyre aluvioneve. Kjo shplarje bëhet atëhere kur shikohet se mbushja e vëllimit të vdekur ka arritur fundin. Frekuenca e shplarjeve varet nga sjellja e prurjeve të ngurta të perroit, p.sh. në stinën e shirave ky vëllim mbushet më shpejt se në stinën e thatë.

Prurja e llogaritese per percaktimin e permasave te dekantuesit eshte pranuar $2.2\text{m}^3/\text{sek}$.

- Vepra e derivacionit.

Ne baze te kushteve topografike dhe gjeologjike vepra e derivacionit do te jete kanal b/a ne anen e majte te rrjedhes me gjatesi $L=7785$ me permasa $B \times H=(130 \times 130)$ cm deri ne hyrje te basenit te presionit.

Tubacioni i Derivacionit

Vepra e derivacionit per nje gjatesi $L=7785$ me permasa $B \times H=(130 \times 130)$ cm do te kaloje ne krahun e djathte te rrjedhjes se perroit duke ndjekur shpatin e pellgut te perroit ne kete seksion me pjeresi 0.15%. vepra e derivacionit eshte parashikuar te jete me kanal b/a sic tregohet ne vizatimin me posht.



Llogaritjet per kanalit e derivacionit i jane bere duke u bazuar ne formulat perkatese per llogaritjen e kanaleve te derivacionit dhe nga keto llogaritje del se kanali I derivacionit ka keto permasa:

Diameter $B \times H = 130 \times 110$ cm dhe bashke me rezerven prej 0.2 m, kanali I derivacionit do kete permasa **$B \times H=130 \times 130$ cm.**

- Baseni i presionit

Te pergjithshme:

Baseni i presionit normalisht vendoset ne pjesen fundore te kanalit te derivacionit dhe ben kalimin nga sistemi pa presion ne ate me presion, midis kanalit te derivacionit dhe tubacionit te turbinave. Baseni zakonisht vendoset ne nje bazament te pershtatshem duke respektuar kushtet topografike dhe gjeologjike. Ne pjesen e sipërme te basenit te presionit derivacioni eshte zakonisht kanal i hapur, tunnel ose tubacion pa presion, ndersa poshte basenit eshte tubacioni nen presion i turbinave, i kesaje forme eshte edhe baseni i HEC Bater

Analiza dhe zgjedhja e tipit te basenit te presionit

Dy jane funksionet kryesore te basenit te presionit :

- Te parashikojë rregullimin e prurjes së turbinës sipas ngarkesës së kërkuar.
- Te parashikojë volumin e rrezervuarit të ujit që të mbajë një nivel konstant të ujit në basen për kontrollin e operimit të turbinës.

Rregullimi i prurjes: kapërdëdhësi automatik i vendosur në muret e basenit, lehtësisht kryen rregullimin e prurjes së turbinës kur ngarkesa e sistemit ndryshon duke devijuar prurjen e tepert mbi kapërdëdhësin automatik dhe derdhen e saj në Perrua. Normalisht në këto mënyre operimi kërkohet që prurja në kanal në shkarkimit të jete me e madhe se prurje që kërkon HEC-i.

Kontrolli i nivelit të ujit: Për hidrocentrale të vegjël të lidhur me rrjetin elektrik është nevojshme që energjia e dhënë nga turbina të jete konstante dhe për këto kërkohet që prurja të jete e qëndrueshme dhe në nivel konstant, në këto mënyre maksimizohet energjia e dhënë nga uji. Kjo arrihet me mënyrën e kontrollit dhe ruajtjes së nivelit të ujit në basen përmes së cilës rregullohet ngarkesa e turbinës me anë të barazimit të prurjes që vjen nga derivacioni me prurjen e kërkuar të turbinës.

Baseni i presionit amortizon dhe rregullon gabimet që mund të ndodhin në kuadrin e paisjeve të turbinës, dhe prurjen hyrëse nga kanali në basenin e presionit. Kjo kërkon që niveli i ujit në basen dhe kanal në shkarkimit të matet dhe të transmetohet në kohe reale në paisjet elektronike komanduese të turbinës që masin dhe rregullojnë parametrat e ndryshëm të turbinës dhe sistemit në teresi (përfshirë prurjen) e cila kërkon mbajtjen e nivelit të ujit në basen brenda niveleve të lejuara.

Për hidrocentralet e vegjël paisjet e kontrollit të ngarkesës së turbinës përfshihen në koston e turbinës, nga kjo kosto përjashtohet matësi i nivelit dhe paisja e transmetimit të të dhënave. Këto HEC-e zakonisht operojnë me nivel të lirë të ujit në basen, në mënyrë që ky nivel të mbahet poshtë kuotes së pragut të kapërdëdhësit automatik. Kjo gjë nuk është problem gjatë përjudhës me prurje të mëdha kur prurja është shumë me e madhe se kërkesa e HEC-it. Sidoqoftë, gjatë përjudhës me prurje të pakta kur prurja e HEC-it është me e madhe se prurja e perroit, është e nevojshme të rregullohet the balanca e ngarkesës në limitin e prurjes së HEC-it (me siguri 90%) të prurjes së perroit.

Përvec këtij funksioni, në raste të tjera baseni presionit kryen dhe funksione si: shpërndarjen e ujit nëpër tubacionet e tjera kur numri i tubacionit të turbinave është me i madh se një si, shkarkimin e ujit kur nxirren nga puna pjesërisht ose plotësisht nga puna agregatet e hidrocentralit, shkarkimin e ujërave të tepërta që mund të hyjnë në basen, largimin e materialit të ngurtë që depozitohet përpara hyrjes së tubacionit, largimin e trupave notues që mund të sillen nga derivacioni etj.

Në rastet me të përgjithshme baseni presionit përbehet nga dy elemente kryesore:

- Paradhoma, e cila është pjesa rrakorduese midis derivacionit dhe pjesës marrese.
- Pjesa e marrjes ose lidhja me tubacionin e turbinave.

Për zgjidhjen hidraulike dhe permasimin e elementeve të basenit të presionit, është e nevojshme të merren disa komponente në konsideratë:

- Hapja (rakordimi) i mureve te behet ne menyre te tille qe te kete nje shperndarje uniforme te prurjes dhe te minimizoje humbjet.
- Kalimi i prurjes nga seksioni i gjere katerkendesh (nga baseni), ne seksionin rrethor (tubacioni i turbinave) te behet me nje hyrje te qete.
- Pajisja me mjete mbeshtetese mekanike, perfshire zgarat dhe porta sherbimi.
- Drejtimi i vendosjes se zgares te behet i tille qe te kaloje prurjen uniformisht.
- Shtjellat, ndrydhjet duhet te eleminohen.

Me ndryshimin e punes se HEC-it del nevoja e shkarkimt te prurjeve te teperta. Per kete qellim prane basenit te presionit vendosen shkarkues me veprim automatik. Aftesia shkarkuese e tyre merret e barabarte me prurjen e plote te HEC-it per rastin me te keq, kur ne tubacion ndodh avari.

Si shkarkues me veprim automatik sherbejne kaperderdhesat me profil praktik, prag te mprehte, gjithashtu perdoren sifonet dhe portat automatike. Kaperderdhesit jane me te thjeshte, por kerkojne nje front te madh shkarkimi, qe rrit keshtu permasat e basenit. Sifonet nga ana tjeter jane me kompakte dhe nuk lejojne ngritje te nivelit, por pune me te komplikuar, ndersa portat automatike jane te komplikuar dhe jo praktike ne shfrytezim.

- Tubacioni i turbinave

Zgjedhja e tipit, numrit dhe trasimi i tubacionit te turbinave

Tubacioni i turbinave transporton ujin nga baseni i presionit per ne ndertesën e centralit ne kushte te caktuara ne rrugen me te shkurter te mundshme dhe ne pergjithesi eshte eshte nje nga veprat me te kushtueshme te Hec-it

Per zgjedhjen e tipit dhe numurit te tubacionit te turbinave me nje pjerresi te caktuara, faktoret kryesore te cilet meren ne konsiderate jane:

- presioni i punes se tubacionit dhe diameteri i tij
- menyra e bashkimit midis tubacioneve
- pesha, thjeshtesia e manovrimit dhe mundesia e instalimit ne pjerresi
- sigurimi i tubacionit
- kerkesat e mirembajtjes dhe jetegjatesia e kerkuar e vepres
- forma e morforelievit ku do te kaloje tubacioni
- cilesia e ujit, klima, vetite fiziko mekanike te bazamentit te trasese

Tubacionet e turbinave dhe ne pergjithesi te gjitha derivacionet me presion, qofshin keta edhe tunele me presion, trasohen ne menyre qe kostua e tij te dali e ulet, te jete i sigurt gjate gjithë perjudhes se shfrytezimit dhe njekohesisht perfitim i renies te jete sa me i madh. Per kete qellim ato duhen kaluar ne rruge sa me te shkurter, duke patur parasysh gjithmone eleminimin e zonave me gjeologji te keqe si dhe zvogelimin ne minimum te veprave te artit.

Per te zgjedhur perfundimisht trasene, behet krahasimi i varianteve te ndryshem dhe pranohet varianti me i pershtatshem. Ndertimi gjeologjik i formacionit eshte faktor kryesor ne zgjedhjen e trasese se tubacionit, prandaj per te patur nje kuader sa me te plote te te dhenave jane bere studime fushore nga grupi i projektimit.

Nga faktoret e permendur mesiper si dhe nga rikonicjoni disa here ne vend e trasese, u arrit ne perfundimin qe traseja e sistemit me presion te HEC Bater te jete nga baseni i presionit me nje gjatesi prej rreth 720 m dhe diameter 1000 mm.

Llogaritjet e fuqise se vendosur dhe prodhimit vjetor te energjise te HEC-it.

Percaktimi i nivelit te ujit ne kanal in e shkarkimit te ndertese se centralit, renies bruto, renies neto te HEC-it.

Hidroelektrocentrali Bater shfrytezon ujerat e perroit te Stames me kuote te Niveli normal te ujit ne Vepren e Marrjes, $\nabla N_{\text{nor}}^{\text{B.S}}=303.00$ m dhe nivel per shkarkim te prurjes se plotes me 1% siguri rreth $\nabla_{\text{shk}}=304.60$ m.

Ujrat e mbledhura nepermjet vepres se marrjes nivelngritese te pajisur me vrime anesore kapese, pasi dekantojne ne vepren kapese te zhavoreve kalojne ne dekantues e pasi dekantohet prurja e ngurte, uji kalon ne vepren e derivacionit dhe perfundon ne basenin e presionit ne kuoten $\nabla=290.90$ m. Niveli i ujit ne basenin e presionit perben edhe nivelin e bjefit te siperm per llogaritjen e renies statike. Niveli i ujit ne bjefin e poshtem eshte llogaritur nga niveli i shkarkimit te ujit nga ndertesa e centralit qe eshte $\nabla N_{\text{nor}}^{\text{B.P}}=159.80$ m dhe kuote te aksit te turbines **161.00 m**. Per tipin e turbines pelton kuota e aksi te turbines merret si nivel i bjefit te poshtem per percaktimin e Renies statike.

Sa me siper Renia bruto e HEC Bater rezulton te jete $H_{\text{bruto}}=129.90$ m. Renia neto ne baze te se ciles llogaritet Fuqia e HEC-it percaktohet duke zbritur humbjet e sistemit me presion dhe ne basenin e presionit. Sistemi me presion konsiston ne nje tubacion me diameter $D=1000$ mm per nje gjatesi $L=720$ m. Humbjet totale gjatesore ne sistemin me presion per prurjen llogaritese $Q_{\text{llog}}=2.2$ m³/sek jane $hw=5.169$ m dhe si rezultat Renia neto e HEC Bater do te jete $H_{\text{neto}}=124.73$ m.

Rendimenti i turbinave dhe elementeve te sistemit ne teresi per llogaritjen e fuqise se vendosur te HEC-it.

Rendimenti i turbines se parashikuar per tu instaluar per nje diapazon deri ne 50% te prurjes se ujit rezulton te jete 89% dhe vetem me 25% te prurjes eshte 85%. Duke marre ne konsiderate humbjet lokale rreth 2% (llogaritjet e sakta te cilat do te behen nga prodhuesi i turbinave), mund te themi qe ne total rendimenti mesatar i sistemit te ndertesese se centralit me nje saktesi te mjaftueshme mund te merret **86 %** per te gjithethe diapazonin e prurjes se ujit.

Llogaritjet e fuqise se vendosur te HEC-it.

Nga parametrat e llogaritur dhe saktuesuar me siper rezulton nje fuqi e vendosur prej:

$$N = 9.81 \times 0.86 \times Q_{\text{llog}} \times H_{\text{neto}}$$

$$N = 9.81 \times 0.86 \times 2.2 \times 124.73 = 2315 \text{ Kw}$$

KONSULTIM ME PUBLIKUN

Llogaritjet e prodhimit vjetor te energjise se HEC-it per vitin mesatar.

Shkalla e shfrytezimit te rrjedhjes vjetore ne aksin e vepres se marrjes se HEC Bater.

Nga te dhenat e vlerave te prurjeve te kurbes se qendrueshmerise, volumi total i rrjedhjes vjetore dha asaj qe kalon ne turbina, ne aksin e HEC Bater rezulton te jete perkatesisht **37,082,093.76 m³** dhe **28,812,965.76 m³**.

Tabela e meposhtme jep rrjedhjet vjetore te perroit ne aksin e HEC Bater dhe rrjedhjes qe kalon ne turbine si dhe shkallen e shfrytezimit te rrjedhjes vjetore per vitin mesatar:

Volumi total (m ³)	Volumi qe shfrytezon Hec-i (m ³)	Shkalla e shfrytezimit (%)
37,082,093.76	28,812,965.76	77.7

Shkalla e shfrytezimit te rrjedhjes vjetore ne aksin e Hec Bater eshte 77.7%. Shfrytezimi me kete perqindje per HEC-e te ketij lloji eshte mjaft i mire.

Pra per fuqine e instaluar **2315 kw** jepet nje prodhim vjetor energjie **E= 8,546,420.36 Kwh/vit.**


Ndertesa e Centralit vendoset ne nje tarrace te pershtatshme ne nje hapsire te nevojshme qe lejon terreni ne kete zone. Thellesia e germimit dhe planimetria e tyre per Ndertesen e Centralit do te percaktohen me saktesi pasi te porositen turbinat dhe pajisjet e tyre elektro-mekanike per te siguruar mbrojtjen nga kavitacioni te tyre. Kuota e shkarkimit eshte paracaktuar te jete **▼shk=159.80 m** duke marre parasysh edhe shfrytezimin optimal te kaskades se perroit te Batres.

Vlerat e kurbes se qendrueshmerise se prurjeve ditore ne aksin e vepres se marjes se HEC Frankth, per vitin mesatar 50% siguri

Ditet	Q=50%
363.6	0.051
360.8	0.068
346.8	0.085
297.4	0.17
255.9	0.283
231.7	0.396

KONSULTIM ME PUBLIKUN

207.2	0.566
175.1	0.792
150.5	0.991
135.1	1.132
116.1	1.302
99.9	1.472
68.6	1.981
35.8	2.83
11	4.245
1.2	7.075
0.1	11.321
0	16.981



Si kriter per percaktimin e prurjes llogaritese eshte konsideruar, prurja qe sigurohet ne te pakten 68 dite gjate nje viti. Nga ana tjeter eshte llogaritur shkalla e shfrytezimit

te rrjedhjes vjetore duke e krahasuar me shkallen e shfrytezimit te kesaj rrjedhjeje ne veprat e ketij lloji nga pervoja Europiane qe lekundet ne kufijte (70-90)% te saj.

Per te percaktuar prurjen llogaritese te HEC-it eshte e detyrueshme te percaktohet prurja e nevojshme per nevoja ambientale te sistemit poshte vepres se marrjes. Kjo prurje eshte llogaritur me nje nga normat e publikuara nga ministria e mjedisit percaktuar te jete sa Q_{355} , ku $Q_{355}=0.075 \text{ m}^3/\text{s}$.

Nga tabela e vlerave te qendrueshmerise se prurjeve per vitin mesatar prurja qe zgjat te pakten 68 dite eshte rreth $1.981 \text{ m}^3/\text{sek}$ e cila merret si prurje llogaritese e HEC-it duke i zbritur prurjen ambientale $0.075 \text{ m}^3/\text{sek}$.

Volumi i rrjedhjes vjetore qe shfrytezohet ne aksin e veprave te marrjes eshte 23,275,874.88 m³.

Shkalla e shfrytezimit te rrjedhjes ne aksin e perroit = 75.64%.

Siç rezulton nga tabela e mesiperme prurja llogaritese vjetore me te cilen shfrytezohet 75.64 % e rrjedhjes vjetore eshte $1.9 \text{ m}^3/\text{sek}$. Si eshte theksuar me siper kjo eshte prurja llogaritese qe kalon ne turbine, pra pasi eshte zbritur prurja ambientale e percaktuar sipas kriterëve te vendosura nga ministria e mjedisit.

Perdorimi i analizave tekniko-ekonomike qe konsistojne ne krahasimin e kostove te energjise vjetore te perfituar perkundrejt kostove shtese per mbi-permasimin e veprave per shkak te pranimit ne vlera te larta te prurjes llogaritese kane rezultuar ne perfundimin qe efekti i rritjes se kostos per mbi-permasimin e veprave eshte pak i ndjeshem kundrejt kostos se energjise vjetore te perfituar. Si rezultat kemi pranuar si Prurje llogaritese ate qe ne nje vit rrjedh per te pakten 68 dite ne vitin mesatar duke zbritur prurjen mbetese ose ambientale.

Si konkluzion, Prurja llogaritese e pranuar per permasimin dhe llogaritjet e te gjitha veprave te Hidrocentralit Frankth eshte pranuar **$1.9 \text{ m}^3/\text{sek}$** .

Vepra e marrjes e HEC Frankth do te vendoset menjehere mbas bashkimit te perroit te stames me nje proske nen godinen e centralit te HEC BATER, me kuote te shtrahit te perroit afersisht $\nabla=435.00 \text{ m}$ dhe kuote te nivelit normal te ujit $\nabla N_{\text{nor}}^{\text{B.S}}=440.00 \text{ m}$.

Vepra e marrjes eshte vendosur te jete nje dige nivel-ngritese rreth 6.8 m e larte e pajisur me nje vrime anesore dhe nje front kaperderdhes, te afte per te shkarkuar prurjen maksimale me 1% siguri te llogaritur ne aksin e saj.

Zgjedhja e tipit te vepres se marrjes te HEC-it, kategorizimi i saj, dhe menyra e kapjes se prurjeve.

Per zgjedhjen e tipit te vepres se marrjes jane bere krahasimet midis

a. vepres se marrjes te tipit me marrje anesore

b. vepres se marrjes tiroleze.

a. vepra e tipit me marrje anesore perdoret ne rastet kur perroi por vecanerisht vendi ku do te vendoset vepra e marrjes ka pjerresi me te vogel se 10%.


b. vepra e marrjes tiroleze prdoret ne rastet kur perroi eshte me pjerresi me te madhe se 10%.

Duke studiuar perruan dhe vendin ku do te ndertohet vepra e marrjes se HEC Frankth kemi vendosur te perdorim vepren e tipit me marrje anesore sepse shtrati i perroit ne kete seksion ka pjerresi me te vogel se 10%, menyra e marrjes se prurjes me ane te kesaj vepre eshte duke hapur nje vrime me permasa bxh=(400x50) cm ne murin e djathte te vepres se marrjes sic tregohet ne vizatimet perkatese te vepres se marrjes.

Vlerat e kurbes se qendrueshmerise se prurjeve ditore ne aksin e vepres se marjes se HEC Selitë, per vitin mesatar 50% siguri

Ditet	Q=50%
363.6	0.027
360.8	0.037
346.8	0.046
297.4	0.091
255.9	0.152
231.7	0.213
207.2	0.304
175.1	0.426
150.5	0.533
135.1	0.609
116.1	0.7
99.9	0.791
68.6	1.07
35.8	1.52
11	2.28
1.2	3.8
0.1	6.09

0	9.13
---	------



Si kriter per percaktimin e prurjes llogaritese eshte konsideruar, prurja qe sigurohet ne te pakten 68 dite gjate nje viti. Nga ana tjetere eshte llogaritur shkalla e shfrytezimit te rrjedhjes vjetore duke e krahasuar me shkallen e shfrytezimit te kesaj rrjedhjeje ne veprat e ketij lloji nga pervoja Europiane qe lekundet ne kufijte (70-90)% te saj.

Per te percaktuar prurjen llogaritese te HEC-it eshte e detyrueshme te percaktohet prurja e nevojshme per nevoja ambientale te sistemit poshte vepres se marrjes. Kjo prurje eshte llogaritur me nje nga normat e publikuara nga ministria e mjedisit percaktuar te jete sa Q_{355} , ku $Q_{355}=0.0407$ m³/s.

Nga tabela e vlerave te qendrueshmerise se prurjeve per vitin mesatar prurja qe zgjat te pakten 68 dite eshte rreth 1.07 m³/sek e cila merret si prurje llogaritese e HEC-it duke i zbritur prurjen ambientale 0.0407 m³/sek.

Si konkluzion, Prurja Llogaritese e pranuar per permasimin dhe llogaritjen Hidrocentralit Selitë eshte pranuar **1.0 m³/sek.**

Vleresimi i rëndesise se ndikimeve te identifikuara (sinjifikanca)

Per te percaktuar me mire masat per kontrollin dhe minimizimin e ndikimeve negative te identifikuara gjate procesit te VNM dhe per te ndihmuar vendimmarrjen e organeve kompetente, ne kete paragraf eshte bere nje kategorizim i rëndesise se çdo ndikimi te mundshem negativ ne mjedis te projektit. Ky kategorizim eshte kryer bazuar ne vlerat mjedisore te zones, legjislacionin mjedisor ne fuqi dhe njohurite mbi teknologjine dhe tekniken e kryerjes se operacioneve ndertimore.

Metodika e vleresimit te rëndesise se ndikimeve te mundshme negative ne mjedis

Kategoria	Pershkrimi
I ulet	Ndikimi eshte i perkohshem, demton pak vlere natyrore si ne cilesi dhe ne sasi (volume). Me perfundimin e operacionit qe e shkakton ai nuk jep me efekte ne mjedis
I mesem	Ndikimi eshte i perkohshem por ne mungese te masave kontrolluese dhe menaxhuese mund te shkaktojte ndikime afatgjata ne vlerat natyrore. Siperfaqja qe tjetersohet nuk rikthehet me ne gjendjen e saj por ze nje raport te pranueshem me siperfaqen totale te zones (koeficienti i tjetersimit) si dhe tjetersohet vetem siperfaqja ndertimore e objektit. Ndikimi nuk perfaqeson shkarkime te ndotesve ne mjedis
I konsiderueshem	Ndikimi eshte i perhershem dhe del pertej zones se ndikuar (zhvendosje, ndotje, zhurma e shkarkime ne ajer). Ndikimi kompromenton normat e shkarkimeve ne mjedis dhe normat e perdorimit te mjedisit
I kthyeshem	Mbaron efektin me ndalimin e shkakut dhe mjedisi i ndikuar rifiton gjendjen e tij natyrale. Demton vlere/zona te mbrojtura dhe unikale
I pakthyeshem	Pasojat e ndikimit jane te pakthyeshme (vazhdojne efektin negativ ne mjedis) edhe pasi perfundon veprimi qe shkakton ndikimin

Vleresimi i rëndesise se ndikimeve negative mjedisore te HEC-it

Tabela e meposhtme paraqet sinjifikancën e ndikimeve te mundshme negative te projektit, identifikuar ne paragrafet e meparshem, ne kontekstin e vlerave mjedisore te zones, legjislacionit mjedisor ne fuqi dhe njohurive mbi teknologjine dhe tekniken e kryerjes se operacioneve ndertimore.

Lloji i ndikimit	Sinjifikanca e ndikimit (sa thelbesor eshte ndikimi)		
	I ulet	I mesem	I larte
Gjenerim i dherave dhe masave drusore			
Gjenerim i mases shkembore			
Dentim i flores ne siperfaqet ku do te kryhen ndertimet			
Ndotje e tokes si pasoje e avarive te mekanikes.			
Erozioni ne kohe me reshje			
Ndikimet ne pejsazhin, relief dhe topografi.			
Ndikimet ne boten e gjalle (faunen)			
Ndikime ne ekosistemet ujore			
Ndikimet ne nivelin e ujrave te pellgut ujembledhes			
Çlirime te zhurmave, gazeve, aromave, dhe pluhurit			
Gjenerim i mbetjeve te ambalazheve etj.			

Ky vleresim eshte mbeshtetur vetem ne disa nga kriteret e listuara me siper dhe ne veçorite e mjedisit ku do te zhvillohet projekti. Mbi kete vleresim do te orientohen edhe masat qe duhet te merren per te zbutur ndikimet, te cilat perbejne edhe Planin e Menaxhimit te Mjedisit.

Identifikimi i ndikimeve te mundshme pozitive dhe rendesia mjedisore e prodhimit te energjise elektrike nga HEC-i

Qellimi i realizimit te ketij projekti eshte prodhimi i energjise elektrike duke shfrytezuar rezervat ujore. Duke vleresuar ndikimet e mundshme ne mjedis te kesaj veprimtarie, kjo forme e prodhimit te energjise elektrike, krahasuar me ate te prodhimit me ane te TEC-ve me hidrokarbure, jo vetem qe nuk ndikon ndjeshem ne mjedis si pasoje e mungeses se shkarkimeve ne ajer per njesi prodhimi, por ndihmon ne uljen e presionit. Ne rastin e prodhimit te energjise elektrike me ane te TEC-ve ky presion rritet per shkak te ndotjes se ajrit nga gazet e çliruar nga djegia e lendes fosile. Kjo menyre prodhimi klasifikohet si perdorim i energjise se natyres apo burimeve te rinovueshme si uji, dhe qendron ne thelb te strategjive te prodhimit te energjise ne shkalle boterore qe synon uljen e varesise nga energjia fosile. Hidrocentralet reduktojne sasine e gazeve serre dhe permiresojne e ruajne gjendjen e atmosferes, cilesine e ajrit dhe shendetin e njeriut. Metodika e njohur e Panelit

Nderkombetar te Ndryshimeve Klimatike qe punoi per hartimin e legjislacionit te Konventes se Kombeve te Bashkuara per Ndryshimet Klimatike rekomadon ndertimin e hidrocentraleve per prodhimin e energjise elektrike me qellim reduktimin e emetimeve te GHG (Green Houses Gases) qe kercenojne planetin sot.

Nga ana tjeter, sigurimi i energjise elektrike nga energjia hidrike do te ndikonte edhe ne uljen e prerjeve te pyjeve ne zone per qellime energjetike si perdorimi i lendes se drurit per djegie etj.

Ulja e presionit mbi pyjet ne zone dhe demtimit te tyre per qellime ngrohje e gatimi do te jete nje nga ndikimet pozitive direkte per mjedisin dhe banoret e zones, por edhe per organet shteterore te administrimit te pyjeve.

Ndikime te tjera pozitive qe rrjedhin nga zbatimi i projektit jane:

- Gjenerimi i te ardhurave per buxhetin e administrates vendore,
- Rritja e prodhimit te energjise elektirike dhe zhvillimi ekonomik i zones,
- Perdorimi i energjise se rinovueshme dhe prodhimi i energjise se paster.

5 PERSHKRIMI PER SHKARKIMET E MUNDSHME NE MJEDIS

Prodhimi i dherave dhe mbetjeve nga veprimtaria ndertimore

Gjate operacioneve te ndertimit do te gjenerohet nje sasi e jo shume e madhe dherash dhe mase shkembore. Kjo sasi dheu klasifikohet si mbetje ndertimore nese lind nevoja te depozitohet apo zhvendoset nga zona ne nje siperfaqe tjeter. Shoqeria qe do te zbatoje projektin duhet te planifikoje qarte menyren e administrimit te dherave per te menjanuar mundesine e depozitimit te tyre pergjate brigjeve te lumit dhe perrenjeve. Nje pjese e kesaj mase dheu mund te perdoret gjate ndertimit te veprave inxhinierike dhe sistemimit te rrugeve e shesheve te sherbimit, ndersa pjesa tjeter do te depozitohet ne vende te caktuara per kete qellim ne marreveshje me organet e pushtetit vendor.

Projekti parashikon sistemimin e materialeve te germuara gjate ndertimit duke i ndare ne siperfaqe dhe volume te tilla duke respektuar kerkesat e ligjit nr. 10 463, datë 22.9. 2011”Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar dhe akteve nenligjore qe rrjedhin prej tij si dhe ligjin 111/2012” Per Menaxhimin e Integruar te Burimeve Ujore” ne bashkepunim me njesite e pushtetit vendor.Para fillimit te operacioneve te ndertimit zhvilluesi do te hartohet Planin e Menaxhimit Mjedisor ku do te kerkohet te miratohet eshte nga institucionet pergjegjese per mbrojtjen e mjedisit.

Do te merren masa qe keto materiale nuk do te hidhen ne afersi te grykave te lumit gje e cila ndalohet dhe me ligj.

KONSULTIM ME PUBLIKUN

Me poshte po japim tabelen e siperfaqeve dhe volumeve qe do te zene inertet e shperndara gjate kaskades, ku pozicioni i tyre eshte teper i favorshem si nga ana e mjedisit te cilat jane zgjedhur te hidhen mbi tarraca te zhveshura nga bimesia dhe pa interes public.

Gjithsesi, per ndertimin e ketyre vendepozitimeve te perkoheshme do te kryhet duke respektuar te gjitha kerkesat dhe percaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” ku percaktohet se:

Ndalohet ndërtimi i vendepozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte në zonat e mëposhtme:

- a. zonë të mbrojtur, arkeologjike, turistike apo në çdo zonë që mbrohet me një akt normativ;
- b. në distancë 300 metrave nga një pus furnizues me ujë dhe çdo burimi tjetër ujqor;
- c. në distancë 100 metrave nga një përrua, argjinaturë lumore, liqen, lum ose kompleks ligatinor;
- d. në distancë 300 metra nga një zonë e mbrojtur në përputhje me pikën (a) më sipër.

Emetimet e zhurmave dhe gazeve te makinerive ne mjedis

Sa lidhet me emetimin e zhurmave gjate fazes ndertimore, duhet theksuar se ky ndikim eshte i perkohshem. Se pari faza e ndertimit eshte nje faze e mirepercaktuar ne kohe dhe se dyti operacionet e ndertimit do te kryhen brenda orareve te zakonshem te punes.

Bazuar edhe ne referencat nderkombetare per projekte te ngjashme vleresohet se zhurmat teknologjike nga mjetet e renda e japin efektin e tyre akumulativ deri ne nje rreze prej 150 - 200m ne varesi edhe te konfiguracionit natyror te terrenit i cili luan rolin e nje barriere natyrale etj. Per rrjedhoje pritet qe te ndikohen negativisht nga zhurmat e pajisjeve te renda si buldozere, eskavatore, kamione etj. vetem qendrat e banuara shume afer zones se projektit (150-200 m).

Sipas natyres se projektit te propozuar, mjetet me te perdorshme ne fazen e ndertimit jane kamionet dhe fadromat, vlerat e emetimit te zhurmave te te cileve jepen ne tabelen e meposhtme.

Pajisja	Vlerat
Kamion	81 – 87 Leq dB (A) ne 15 m
Fadrome	76- 78 Leq (dB(A) ne 15 m

Nderkohe Udhezimi nr.8 date 27.11.2007 "Per nivelet kufi te zhurmave ne mjedis te caktuara", percakton vlerat e lejuara te zhurmes si ne tabelen e meposhtme.

KONSULTIM ME PUBLIKUN

Nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara

<i>Mjedisi</i>	Efekti kritik ne shendet	LA _{eq} (dBA)	Koha baze (ore)	LA _{max} Fast (dB)
Zona banimi				
Jashte banese	Bezdi (shqetesim) serioze gjate dites dhe mbremjes	55	16	-
	Bezdi (shqetesim) i moderuar gjate dites dhe mbremjes	50	16	-
Ne brendesi te banesave	Kuptueshmeri e bisedes dhe (bezdi) shqetesim i moderuar gjate dites dhe mbremjes	35	16	-
Ne brendesi te dhomes se fjetjes	Prishja e gjumit naten	30	8	-
Jashte dhomes se fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur (vlere nga jashte)	45	8	-
Zona me aktivitetet social-ekonomik				
Zona industriale, tregtare, qarkullimi trafiku (mjedis i jashtem dhe i brendshem)	Demtim degjimi	70	24	110
Mjedis urban				
Mjedise publike, te jashtme apo te brendshme	Demtim degjimi	85	1	110

Shpjegime:

- LA_{eq} (dBA) = Niveli ekuivalent i matur ne shkallen A
- Koha baze (ore) = Koha gjate se ciles behet matja
- LA_{max} Fast (dB) = Niveli i matur ne shkallen A ne menyren Fast (e shpejte)
- # 1 = Sa me e ulet qe te jete e mundur
- # 2 = Presioni zanor maksimal (LA_{max}, fast) matur 100 mm larg veshit
- # 3 = Zonat e jashtme te qeta duhet te mbrohen dhe raporti i zhurmave hyrese/shtese me zhurmen e fonit natyral duhet te ruhet sa me i ulet qe te jete e mundur
- # 4 = Nen kufjet e degjimit, pershtatur me vlerat e fushes se lire

Nga krahasimi i nivelit te zhurmave qe çlirojnë mjetet e punës me ato kufi te lejuara sipas Udhezimit nr.8 date 27.11.2007 "Per nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te

caktuara”, verehet se nivelet e lejuara te zhurmave ne qendrat e banuara me te aferta gjate kohes se zbatimit te projektit mund te tejkalohen. Ndonese qendrat e banuara jane relativisht te distancuara nga zona ku do te kryhen punime, rekomandohet qe firma zbatuese e projektit te punoje me eficence per te menjanuar oret e te zgjatura te punes dhe punimet ne oret e para te mengjesit ose ne mbremje.

I njeiti arsytim vlen edhe per sasine e gazeve dhe pluhurave qe do te emetohen si pasoje e djegies se karburantit ne motore dhe levizja e automjeteve.

Duke mbajtur parasysh qe zona e propozuar per zhvillimin e projektit ka karakter rural dhe eshte mjaft larg stresit industrial, ndotja e ajrit si pasoje e operacioneve te ndertimit te veprave inxhinierike dhe qarkullimit te automjeteve vleresohet te mos i tejkaloje normat e cilesise se ajrit per qendrat e banuara.

Njekohesisht firma zbatuese duhet te njohe dhe zbatoje kerkesat e Rregullores Nr. 1 date 15.03.2006 “Per parandalimin e ndikimeve negative ne shendet e ne mjedis te veprimtarive ndertimore”.

6 INFORMACION PER KOHEZGJATJEN E MUNDSHME TENDIKIMEVE NEGATIVE TE IDENTIFIKUARA;

Kohëzgjatja e ndërtimit të veprave do të jetë 12 muaj nga data e marrje së lejes së ndërtimit.

Projekti që do implementohet nuk është objekt koncensionit por një objekt me pronësi private.

Sipërfaqja që do të preket do të rehabilitohet paralel me kohën dhe fazën e ndërtimit.

7 TE DHENA PER SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPESINORE TE NDIKIMIT NEGATIV NE MJEDIS

Zbatimi i projektit per ndertimin e HEC-eve Bater, Frankth dhe Selite do te kerkoje shfrytezimin e burimeve natyrore e per rrjedhoje operacionet qe do te kryhen ne fazen e ndertimit te tij do te kene ndikime ne mjedisin prites. Analiza e kryer ne kete raport ne lidhje me ndikimet e mundshme ne mjedis te projektit tregon se ato jane te kufizuara dhe pa pasoja te rëndesishme dhe te pakthyeshme. Po keshtu edhe kohezgjatja e ndikimeve qe mund te konsiderohen te rëndesishme eshte e limituar. Vlen te ritheksohet se projektet e prodhimit te energjise me ane te HEC-it, te cilet perdorin burime te rinovueshme, jane ne listen e rekomandimeve dhe prioriteteve te politikave mjedisore sot ne rrafshin global pasi energjia e prodhuar ne kete menyre quhet ndryshe energji e paster. Nga analiza del se bilanci i ndikimeve negative te veprimtarise dhe atyre pozitive eshte ne favor te ketyre te fundit. Ndertimi dhe venia ne shfrytezim e ketij hidrocentralido te ndihmonte ne nje mase te konsiderueshme

zgjidhjen e problemit të furnizimit me energji elektrike në zone duke siguruar prodhimin e energjise se paster nga burime të rinovueshme.

8 REHABILITIMIT I MJEDISIT TE NDIKUAR

Ndonese ne VKM Nr. 1189, date 18.11.2009 “Per rregullat dhe procedurat per hartimin dhe zbatimin e programit kombetar te monitorimit te mjedisit” percaktohen qarte indikatorët mjedisore qe duhet te monitorohen, ata duhet te pershtaten dhe t’i perkasin veprimtarise. Qellimi i monitorimit mjedisor per veprimtarine e HEC-Bater eshte qe te siguroje te dhena nepermjet te cilave te vleresohet nese zhvillimi i veprimtariseeshte ne perputhje me ligjet dhe standartet mjedisore qe lidhen me te, si dhe per te vleresuar performancën mjedisore te menaxhimit te saj ne kuader te permiresimit te vazhdueshem.

Treguesit e monitorimit

Elementi i monitorimit	Frekuenca	Pergjegjesi
Sasia e ujit ne perrua para marrjes se tij dhe devijimit per ne HECe	Periodike	Kompania shfrytezuese
Sasia e ujit ne perrua pas marrjes se tij dhe devijimit per ne HEC (ne vazhdim te rrjedhes natyrale)	Periodike	Kompania shfrytezuese
Sasia e ujit ne perrua pas shkarkimit nga HECet (ne vazhdim te rrjedhes natyrale)	Periodike	Kompania shfrytezuese
Sasia e ujit qe do te perdoret nga Hidrocentralet	Periodike	Kompania shfrytezuese
Parametrat fiziko –kimike te ujit te perdorur para marrjes dhe futjes ne turbina <i>Analize e plote: parametrat fizike, temperatura, pH, llumrat dhe lenda e ngurte, etj.</i>	Periodike	Kompania shfrytezuese
Parametrat fiziko –kimike te ujit te perdorur pas shkarkimit ne perrua	Periodike	Kompania shfrytezuese
Gjendja e flores dhe faunes ne zonen ne afersi te infrastruktures dhe veprave inxhinjerike te HECeve	Periodike	Kompania shfrytezuese
Niveli i zhurmes ne afersi te centralit	Periodik	Kompania shfrytezuese

Indikatorët e mesiperm të monitorimit janë një ndërthurje treguesish me të cilët vlerësohet objektivisht gjendja e mjedisit dhe ndikimi i ndertimit dhe funksionimit të hidrocentralit në këto gjendje.

Rregjistrimi i të dhënave mjedisore

Matja dhe mbledhja e të dhënave për treguesit e mesiperm do të bëhet duke zbatuar metodat dhe teknikat shkencore të njohura dhe të pranueshme. Për të ruajtur të dhënat mjedisore të veprimtarisë do të përgatitet dhe mbahet një regjistër i veçantë ku ato do të hidhen në mënyrë të vazhdueshme. Të dhënat që do të mbledhen do të vihen në dispozicion të organeve shtetërore dhe të interesuarve të tjera për t'i analizuar me qëllim vlerësimin e performancës mjedisore të veprimtarisë dhe kryerjen e përmirësimeve të nevojshme.

9 MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS;

Parimet e Planit të Menaxhimit të Mjedisit dhe Masave Zbutëse

Për menjanimin dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis të identifikuar në seksionin paraardhës, kompania do të hartojë dhe zbatojë me përpikëri një Plan të Menaxhimit të Mjedisit dhe masave zbutëse i cili ka për qëllim parandalimin ose minimizimin e ndotjes dhe dëmtimit të mjedisit si dhe shëndetin e sigurinë në punë.

Plani i Menaxhimit të Mjedisit synon respektimin e standardeve mjedisore gjatë kryerjes së aktiviteteve ndërtuese të HEC-ve dhe me pas shfrytëzimit të tij, në mënyrë të sigurt dhe efektive, me qëllim final mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit. Konkretisht, ai fokusohet në ndikimet e identifikuar në mjedis në fazat e ndertimit dhe të shfrytëzimit të vepres, masat përkatëse menjauese ose minimizuese dhe institucionet përgjegjëse.

Masat e nevojshme për zbutjen e ndikimeve

Masat kryesore të propozuara në Planin e Menaxhimit të Mjedisit duhet të adresojnë zgjidhjet më optimale për minimizimin e ndikimeve të identifikuar negative në mjedis. Këto masa duhet të synojnë:

- rehabilitimin e sipërfaqeve që do të përdoren dhe ndikohen nga veprimtaria ndërtimore,
- sistemin e masës inerte shkëmbore që do të dalë nga hapja e tuneleve dhe trasese për vendosjen e tubacionit. Do të konkludohet në bashkëpunim me përfaqësuesit e pushtetit vendor për vendin ku do të depozitohen këto masa shkëmbore, ndërkohë që një pjesë e tyre mund të përdoret edhe për

KONSULTIM ME PUBLIKUN

ndertimin e veprave te hidrocentraleve ose per sistemime ne zonen e projektit,

- kontrollin e erozionit,
- llogaritjen e prurjeve ekologjike (rreth 12-15% e Q/min) dhe programimin e leshimit te ketij faktori pergjate rrjedhes egzistuese,

Zbatimi me korrektesi i ketyre masave do te behet i mundur nga perdorimi i teknikave te meposhtme:

- piketimi i sakte i siperfaqes ku do te ndertohet dhe kufizimi i veprimtarise vetem brenda saj,
- kontrolli i pluhurave nepermjet lagies se zones se punes dhe mbulimit te makinerive gjate transportit,
- kontrolli i dherave te gjeneruara dhe sistemimi i tyre nepermjet kompakesimit,
- hapja e kanaleve te nevojshem per drejtimin e ujrave te shiut me qellim zvogelimin e erozionit,
- kontrolli teknik i mjeteve te punes per te parandaluar rrjedhjet e karburantit.

Plani i Menaxhimit te Mjedisit dhe masat perkatese per zbutjen e ndikimeve

Lloji i ndikimit	Masat per zbutjen e ndikimit	Komente mbi efektshmerine e masave
Gjenerim i masave te dherave dhe atyre shkembore si pasoje e hapjes se tuneleve, traseseve tubacioneve dhe themeleve te veprave inxhinierike	Piketimi i sakte i siperfaqes ku do te punohet; Perdorimi maksimal i rrugave ekzistuese; Perdorimi i mases shkembore per ndertimin e veprave inxhinierike dhe sistemime ne zone; Sistemimi i dherave per perdorim ne rehabilitimet e mundshme; <i>Per kryerjen e ketyre operacioneve do te bashkepunohet me organet e pushtetit vendor</i>	Ndikimi mbahet brenda kufijve te tij natyrale. Minimizohet efekti negativ i gjenerimit te mbetjeve inerte permes kthimit te tyre ne lende te pare per ndertim.

KONSULTIM ME PUBLIKUN

<p>Emetim zhurmash, gazesh, aromash dhe pluhuri</p>	<p>Kontrolli periodik i makinerive per te siguruar emetim brenda normave te lejuara si per gazet ashtu edhe per zhurmat ;</p> <p>Planifikimi paraprak i punes dhe realizimi ne kohe sa me te shkurter,</p> <p>Transporti i mbetjeve dhe lendeve te para per ndertim me kamione te mbuluar,</p> <p>Lagia e herepashereshme me uje (veçanerisht ne kohe te thate) e siperfaqeve te punes.</p>	<p>Mbajtja e cilesise se ajrit brenda kufijve normale.</p> <p>Ulet koha e zgjatjes se ndikimit.</p>
<p>Erozion i siperfaqeve ku do te zhvillohen punimet ne mot me reshje</p>	<p>Planifikimi paraprak i punes dhe realizim i operacioneve ne kohe sa me te shkurter;</p> <p>Hapja e kanaleve perimetrike te thelle sipas gradientit te pjerresisedhe levizjes se mases.</p>	<p>Dobesohet efekti gerryes i pikes se shiut, pra minimizohet mundesia per erozion</p>
<p>Ndotje e tokes si pasoje e avarive te mekanikes</p>	<p>Kontrolli dhe testimi periodik i gjendjes teknike te makinerive</p>	<p>Mbrojtja e tokes dhe ujrave siperfaqesore dhe atyre nentokesore</p>
<p>Ndikime ne nivelin e ujrave te perroit te Shutines</p>	<p>Kontrolli paraprak i sasise se leshimit te ujit nga vendmarrja per te mos demtuar rrjedhjen;</p> <p>Nderprerja e prodhimit te energjise ne periudha me mot te thate nese verehet se demtohen rrjedhat natyrale te poshtme te burimeve.</p>	<p>Optimizimi i prurjes ekologjike, e cila do te jete 12-15% e prurjes minimale mujore te llogaritur nga viti mesatar shumevjeçar</p>
<p>Ndikime ne boten e</p>	<p>Ndalja e punimet gjate</p>	<p>Krijohen kushtet e nevojshme qe kafshet</p>

KONSULTIM ME PUBLIKUN

<p>gjalle (flora dhe fauna)</p>	<p>oreve te nates; Inspektimi para fillimit te operacioneve per te analizuar me kujdes sjelljet e botes se gjalle dhe per te percaktuar momentet e nderprerjes se aktivitetit ne faza te caktuara te ciklit vjetor te zhvillimit te biodiversitetit, si p.sh. koha e riprodhimit; Pastrim i pluhurit dhe lagie e luleses dhe organeve te riprodhimit te bimev; <i>Vleresime me te sakta per masat e duhura do te jepen ne vitin e dyte, mbas monitorimit te biodiversitetit ne zone gjate vitit te pare te veprimtarise</i></p>	<p>te levizin ne zone, gjuajne dhe riprodhohen. Kujdesi do te vazhdoje deri ne çeljen dhe levizjen e te vegjelve nga folete Krijimi i kushteve per zhvillimin normal dhe riprodhimin e bimeve</p>
<p>Gjenerim i mbetjeve te ambalazhe</p>	<p>Vendosja e konteniereve per hedhjen e mbeturinave dhe depozitimi i tyre ne perputhje me planet lokale te menaxhimit te mbetjeve</p>	<p>Menjanohet ndotja e mjedisit nga mbetje me natyre te ndryshme</p>

Per zbatimin e Planit te Menaxhimit te Mjedisit kompania do te trajnoje personelin e saj dhe do te mbaje komunikim te vazhdueshem me eksperte te fushes dhe specialiste te strukturave pergjegjese per mjedisin.

Efikasiteti i masave te Planit te Menaxhimit te Mjedisit do te vleresohet me rezultatet konkrete te monitorimit te vazhdueshem te performances mjedisore te vepres. Ne varesi te ketyre rezultateve dhe problemeve te adresuara Plani i Menaxhimit te Mjedisit eshte objekt permiresimi te vazhdueshem.

10 NDIKIMET E MUNDSHME NE MJEDISIN NDERKUFITAR (NESE PROJEKTI KA NATYRE TE TILLE).

Konventa "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis ne kontekst nderkufitar (Konventa ESPOO)" ka per qellim vleresimin e ndikimit ne mjedis te projekteve qe zhvillohen kryesisht ne zona nderkufitare dhe qe mendohet qe mund te kene ndikim ne mjedisin e vendeve fqinje. Shqiperia eshte pale ne kete Konvente qe prej 4 Tetorit te vitit 1991. Kjo Konvente synon bashkepunimin midis shteteve per mbrojtjen e mjedisit nderkufitar nga projektet me ndikim ne mjedis nepermjet:

- Njoftimit paraprak te shtetit, mjedisi i te cilit mund te ndikohet nga nje projekt i caktuar. Njoftimi behet nga Shteti, i cili synon te zbatoje projektin ne territorin e tij, i cili e fton Shtetin qe mund te ndikohet te marre pjese ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis te projektit te propozuar, duke i dhene kohe te mjaftueshme dhe vene ne disponim raportin e vleresimit te ndikimit ne mjedis te projektit te propozuar;
- Duke e njoftuar Shtetin e ndikuar per vendimin perfundimtar per projektin dhe kushtet per mbrojtjen e mjedisit qe duhet te respektohen.

Gjthashtu nga Shqiperia jane ratifikuar edhe amendamentet e saj, vendimet II/14 dhe III/17, nepermjet Ligjit Nr. 9478, date 16.02.2006 "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne vendimet II/14 dhe III/17, Amendamentet e Konventes se ESPOO-s "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis, ne kontekst nderkufitar".

Subjekt i kesaj konvente jane te gjitha projektet e listuara ne shtojcen I te kesaj Konvente, ose me sakte ne Amendamentin e dyte te kesaj Konvente, ku jane listuar te gjitha projektet qe i nenshtrohen kerkesave te kesaj konvente.

Projekti i propozuar ben pjese ne piken 11 te kesaj liste "Diga te medha dhe rezervuaret" dhe duke qene se projekti i propozuar eshte ne afersi me kufirin e republikes se Maqedonise (FYROM) dhe me Republikën e Kosoves, dhe mbi te gjitha eshte parashikuar te shfrytezohen ujrat e nje burimi ujqor nderkufitar. Nga sa me siper, Republika e Shqiperise do te ftoje dy shtet e sipercituar per te marre pjese ne proceduren e vleresimit te ndikimit ne mjedis.

Hartoj Raportin

Emanuela Arifi

Ekspert i VNM dhe Auditimit Mjedisor

"ESDO" Sh.p.k.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LICENSIMIT

AN240820220001

Tiranë, më: 20.09.2022

Komisioni 63

VENDIM

PËR VNM TE THELLUAR

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 ‘Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440, date: 07.07.2011, ‘Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis’, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, ‘Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore’, AKM-ja pas përfundimit të procedurës paraprake të VNM-së, vendosi që ky projekt **duhet t’i nënshtrohet procedurës së VNM-së së thelluar** për zhvilluesin me të dhënat si më poshtë:

Person juridik: “Electral Batra HPP” sh.p.k.

Nr. NIPT-i: L62423006M

Adresa e selise: Tiranë, Rr.“S. Frashëri”, qendra “Metropol”, pll. “Vortek”, Nr.14, kt.2, përballë Drejtorisë së Policisë

Personi përgjegjës: Indrit Gashi

Për të zhvilluar projektin: "Ndërtimi i HEC Batër, Frankth, Selitë ”

Vendndodhja: Bashkia Mat, Qarku Dibër

Fuqia e instaluar:

Fuqia e instaluar: 6 330 kW

Bazuar në nenin 11, të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar më poshtë po listojmë:

1. Arsyet dhe konsideratat kryesore ku është mbështetur ky vendim:

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10 440” , datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, Neni 9, “Projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”, Pika 1. Procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen: b) projektet, për të cilat vendimi i AKM-së parashikon nevojën e zbatimit të kësaj

procedure, AKM gjykon se ky aktivitet duhet t'i nënshtrohet Procedurës së Thelluar të VNM-së, për arsye si më poshtë:

- Fuqia e madhe e instaluar në vepër
- Ky aktiviteti do të ketë ndikime të konsiderueshme në biodiversitetet
- Projekti vlerësohet kompleks, ndikimi në mjedis është shumë i madh dhe për këtë duhet bërë nje Vlerësim i Thelluar i Ndikimit në Mjedis.

2. Qëndrimin e Drejtorive Teknike:

Drejtorite teknike të Ministrisë shprehen: - Gjatë ndërtimit të veprimtarisë, mbetjet e gjeneruara të menaxhohen sipas kuadrit ligjor në fuqi në fushën e mbetjeve dhe biodiversitetit si më poshtë:

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr.575, date 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;
- VKM nr.177, datë 06.03.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”;
- VKM nr. 99, datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, i ndryshuar;
- VKM nr. 765, datë 07.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”;
- VKM nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”;
- VKM nr. 371, datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”;
- VKM nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”;
- Ligji nr 10463, datë. 22/09/2011, “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” i ndryshuar.
- Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 41/2017, datë 4.5.2017 “Për zonat e mbrojtura”.

Sa i përket fushës së cilësisë së ajrit në mjedis, menaxhimit të kimikateve si dhe asaj të ndryshimeve klimatike, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit shprehet se:

- Pavarësisht se energjia e prodhuar nga hidrocentralet konsiderohet energji e pastër, pasi nuk shoqërohet me çlirime gazesh të dëmshëm në atmosferë, përsëri këto HEC-e kanë ndikimin e tyre në mjedis, duke qënë se skenarët e ndryshimeve klimatike parashikojnë çrregullim të reshjeve në Shqipëri, me pakësimin e tyre gjatë periudhës së verës, dhe uljen e shpeshësisë, si dhe rritjen e intensitetit të tyre gjatë periudhës së dimrit (sipas raportit të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike-IPCC 2021).

- Një tjetër ndikim negativ që HEC-et kanë në mjedis ka të bëjë me faktin se ndërtimi HEC-eve kërkon heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve ku do të ndërtohen, e cila ndikon në reduktimin e sipërfaqeve të gjelbëra, që konsiderohet si një nga depozituesit kryesor të karbonit në planet.

Sugjerohet të përditësohet baza ligjore për “Pyjet” dhe të përshkruhet se si do të bëhet rehabilitimi i sipërfaqes sipas veprave të projektit. Gjithashtu sugjerohet që rehabilitimi nëpërmjet pyllëzimit të shoqërohet me ndërtimin e pritave malore.

Sugjerohet të merret mendimi i AKZM për të verifikuar koordinatat sepse aplikimi përmban 3 ndërtimesh HEC në të njëjtin përrua.

Sugjerohet që subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit duhet t'i përmbahet legjislacionit në fuqi, konkretisht ligjit nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”.

Duke patur parasysh se zhvillimi i aktiviteteve të kësaj natyre kanë ndikime të konsiderueshme në biodiversitet, sugjerojmë që ky projekt t'i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së, gjatë së cilës do të zhvillohet informimi, konsultimi dhe dëgjesa publike për të marrë mendimin e publikut, për ushtrimin e këtij aktiviteti.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet: Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti “HEC Selitë, Frankth, Batër”, me zhvillues dhe aplikues “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k, me nr. Aplikimi AN240820220001, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër sugjeron marrjen në konsideratë të rekomandimeve të mëposhtme:

1. Në raport jepet përshkrimi i ndikimeve negative që do kete gjate fazes se pergatitjes dhe ndertimit te HEC-eve, por nuk pershkrhet në menyre te plote dhe te detajuar masat qe do te merren per rehabilitimin e zones pas ndertimit.
2. Te kihet kujdes ne ndërtimin e rrugëve hyrëse per te mos shkaktuar degradimin e karakteristikave të peizazhit natyror.
3. Te shmanget heqja e vegjetacionit natyror, gërmimi në shpatet e pjerrëta, pasi mund te behen shkak për erozion si pasojë e punimeve.
4. Mbetjeve e ndërtimit, si materialet e gërmimit te mos depozitohen në brigjet e lumenjve ose në shtratin e lumit.
5. Te mos kete devijime te rrjedhjes se ujit e cila është një përcaktues kryesor i biodiversitetit, devijimi i saj do te kete pasoja dhe per biodiveristetin.

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore shprehet se: Në përgjigje të kërkesës suaj mbi aplikimin për VNM paraprahe të subjektit “ELECTRAL BATRA HPP”sh.p.k me zhvillues projekti subjekti “ELECTRAL BATRA HPP” me të dhënat: Nr. AN240820220001, të datës 24.08.2022, ju sqarojmë se: Subjekti “ELECTRAL BATRA HPP” nuk ka leje për përdorim burimi ujqor nëpërmjet Hec Bater, Frankth, Selitë. Përsa më sipër, pas mbarimit të procedurave për VNM paraprahe, subjekti “ELECTRAL BATRA HPP” duhet të aplikojë në portalin on-line të e-albania “Aplikim për përdorim burim ujqor” për t’u pajisur me leje bazuar në ligjin Nr. 111/2012 “Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të ndryshuar si dhe VKM-së nr. 550, datë 15.7.2020.

Ky projekt duhet t’i nënshtrohet procedurës së VNM-së së thelluar.



DREJTORI I PËRGJITHSHËM


Konceptoi:

Konfirmoi:

Pranoi:

Aneksi 1. Planvendosja e sipërfaqes së objektit







REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LIÇENSIMIT

AN031020220002

Tiranë, më: 31.10.2022

Lënda: Njoftim për vazhdim procedurë për VNM të Thelluar “Electral Batra HPP” sh.p.k.

“Electral Batra HPP” Sh.p.k.

Tiranë, Rr.“S. Frashëri”, qendra “Metropol”, pll. “Vortek”, Nr.14, kt.2, përballë
Drejtorisë së Policisë

MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT

Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Turizëm dhe Mjedis

Agjencia Kombëtare e Mjedisit mori në dorëzim kërkesën e subjektit “Electral Batra HPP” Sh.p.k. me nr. AN031020220002 aplikimi, datë 03/10/2022 në lidhje me procedurën për njoftim të procedurësë thelluar të VNM-së për projektin “Projekti hidrocentralet Batër, Frankth, Selitë”, me vendndodhje në përroin e Batrës, Bashkia Mat Bazuar në VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, AKM- ja, pas marrjes së mendimeve nga institucionet e tjera, njofton, me shkrim, zhvilluesin për çështje që duhet të trajtojë në raportin e thelluar të VNM-së, duke vënë në dijeni dhe ministrinë si më poshtë vijon:

1. Qëndrimi i Drejtorive Teknike:

Drejtoritë teknike të Ministrisë, shprehin mendimin si më poshtë: Sugjerojmë që gjatë hartimit të raportit të VNM-së së thelluar të mbahen në konsideratë aktet ligjore në fuqi për fushën e mbetjeve dhe biodiversitetit:

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr.575, date 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;
- VKM nr.177, datë 06.03.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”;
- VKM nr. 99, datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, i ndryshuar;
- VKM nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”;
- VKM nr. 371, datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”;
- VKM nr. 765, datë 07.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”;
- VKM nr.227, datë 12.03.2020 ”Për propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10463”, datë 22.09.2011 ”Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;
- VKM nr.402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve”;

- Vendim nr. 232, datë 26.4.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 177, datë 6.3.2012, të këshillit të ministrave, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”;
- VKM 652, date 14.09.2016 “Per rregullat dhe kriteret per menaxhimin e mbetjeve nga gomat e perdorura”;
- Vendim nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”;
- VKM nr. 418, datë 27.05.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035”;
- Ligji nr 10463, datë. 22/09/2011, “Për Menaxhmin e Integruar të Mbetjeve” i ndryshuar.
- Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, i ndryshuar.

Pavarësisht se energjia e prodhuar nga hidrocentralet konsiderohet si energji e pasër, pasi nuk shoqërohet me çlirime gazesh të dëmshëm në atmosferë, përsëri këto HEC-e kanë ndikimin e tyre në mjedis, duke qënë se skenarët e ndryshimeve klimatike parashikojnë çrregullim të rreshjeve në Shqipëri, me pakësimin e tyre gjatë periudhës të verës, dhe uljen e shpeshtësisë, si dhe rritjen e intensitetit të tyre gjatë periudhës së dimrit (sipas raportit të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike-IPCC 2021).

Një tjetër ndikim negativ që HEC-et kanë në mjedis ka të bëjë me faktin se ndërtimi i HEC-eve kërkon heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve ku do të ndërtohen, e cila ndikon në reduktimin e sipërfaqeve të gjelbëra, që konsiderohet si një nga depozituesit kryesorë të karbonit në planet.

o Sektori i pyjeve vëren se;

- Baza ligjore për Sektorin e Pyjeve e gabuar (faqe 9-10, të raporteve);
- Nuk kuptohet dokumentacioni bashkëngjitur këtij aplikimi lidhur me sipërfaqet në Hotolisht të bashkisë Librazhd;
- Nuk jep treguesit kadastralë dhe formën e përdorimit të pronës pyll/kullotë;
- Bën përshkrime të përgjithshme e të pavënd për një projekt të tillë;
- Nuk parashtron dhe nuk përshkruan asgjë për rehabilitimin;
- Nuk gjendet asnjë dokumentacion ku Bashkia Mat të jetë e përfshirë;
- Në çdo rast duhet të kihet parasysh zbatimi me rigorizitet i nenit 12, të ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”.

o Sugjerojmë që gjatë fazës së hartimit të raportit të VNM-së së thelluar, të përshkruhen masat zbutëse për ndikimin në mjedis për fushën e biodiversitetit dhe të mbetjeve sipas detyrimeve që rrjedhin nga aktet ligjore në fuqi.

Raporti i thelluar duhet të strukturohet dhe të përmbajë të gjithë informacionin e kërkuar në shtojcën II të VKM nr. 686/2015.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet se: Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti “HEC Selitë, Frankth, Batër”, me zhvillues dhe aplikues “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k, me nr. Aplikimi AN031020220002, nuk ndodhet brenda rrejtës të zonave të mbrojtura.

Agjencia Rajonale e Mjedisit shprehet Tiranë, Durrës, Dibër, Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti ELECTRAL BATRA HPP, për projektin “Ndërtim I Hidrocentraleve Bater, Frankth, Selite” me vendndodhje Perroi Batres, Bashkia Mat, sugjeron marrjen në konsideratë të rekomandimeve të mëposhtme:

1. Te kihet kujdes ne ndërtimin e rrugëve hyrëse per te mos shkaktuar degradimin e karakteristikave të peizazhit natyror.
2. Te shmangët heqja e vegjetacionit natyror, gjërmimi në shpatet e pjerrëta, pasi mund te behen shkak për erozion si pasojë e punimeve.
3. Mbetjeve e ndërtimit, si materialet e gjërmimit te mos depozitohen në brigjet e lumenjve ose në shtratin e lumit.

4. Te mos kete devijime te rrjedhjes se ujit e cila është një përcaktues kryesor i biodiversitetit, devijimi i saj do te kete pasoja dhe per biodiveristetin

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore shprehet: Në përgjigje të kërkesës suaj mbi aplikimin për VNM të thelluar të subjektit “ELECTRAL BATRA HPP” me zhvillues projekti subjekti “ELECTRAL BATRA HPP” me të dhënat: Nr. AN031020220002, të datës 03.10.2022, ju sqarojmë se:

Subjekti “ELECTRAL BATRA HPP” nuk ka leje për përdorim burimi ujqor nëpërmjet Hec Bater, Frankth, Selitë. Përsa më sipër, pas mbarimit të procedurave për VNM të thelluar, subjekti “ELECTRAL BATRA HPP” duhet të aplikojë në portalin on-line të e-albania “Aplikim për përdorim burim ujqor” për t’u pajisur me leje bazuar në ligjin Nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të ndryshuar si dhe VKM-së nr. 550, datë 15.7.2020.

Qëndrimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit:

Në hartimin e VNM-së së thelluar subjekti duhet të paraqesë dhe të plotësojë informacionin në si më poshtë:

- a) Kërkesat e Ministrisë së Mjedisit, të cilat duhet të merren parasysh dhe të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së.
- b) Subjekti duhet të hartoj strukturën dhe renditjen e informacionit në raportin e VNM –së së Thelluar, në përputhje me shtojcën II të VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”
- c) Subjekti gjatë hartimit të VNM së thelluar duhet të kryej Konsultimin me publikun në bazë të VKM-së nr 247, datë 30.4.2014. “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore” duke njoftuar AKM-në paraprakisht për këtë takim.
Në këtë takim duhet të ketë një pjesëmarrje të gjerë, me banorë të cdo fshati që preket nga zhvillimi këtij projekti, duke qënë se projekti ka një shtrirje të gjerë.
- d) Raporti Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis duhet të jetë i detajuar, duke përcaktuar qartë shkarkimet në mjedisin rrethues (tokë, ujë, ajër) gjatë fazës së ndërtimit dhe funksionimit.
- e) Të detajohen masat për menaxhimin e mbetjeve të amballazheve dhe mbetjeve inerte të gjeneruara gjatë punimeve.
- f) Përshkrimin e sipërfaqes bimore, florës dhe faunës së zonës ku do të zbatohet projekti, (i detajuar dhe te jepen te sakta referencat kadastrale te siperfaqeve pyjore te prekura nga aktiviteti).
- g) Sistemi i mbrojtës kundër zjarrit dhe masat mbrojtëse ndaj aksidenteve të papritura gjatë fazës së instalimit dhe funksionimit.
- h) Raporti teknik të hartohet duke u bazuar në VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”.
- i) Plani i rehabilitimit dhe monitorimit të zonave të prekura gjatë ndërtimit dhe pas përfundimit të veprës rehabilitimit e sipërfaqes duhet të bëhet në mënyrë progresive sipas planit të ndërhyrjes dhe pikës 6, të VKM nr.664, datë 10.10.2019.
- j) Raporti Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis si dhe Relacioni Teknik të përmbajë planimetritë dhe koordinatat e projektit.
- k) **Të bashkangjiten në Raportin Teknik dhe Raportin e thelluar të VNM-së të gjitha lejet dhe licencat që zotëron subjekti për këtë lloj aktiviteti, si detyrim ligjor që vjen nga VKM nr.686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjësive e**

afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, Kreu II, Pika 10/c).

- 1) Materiali të jetë origjinal ose i noterizuar, çdo leje/licencë apo dokument fotokopje nuk do të pranohet.


Për sa më sipër, të hartohet Raporti i thelluar i VNM-së dhe të paraqitet në dosje edhe dëgjesa me publikun, sipas legjislacionit në fuqi.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Konceptoi:

Konfirmoi:

Pranoi:



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 5146 Prot.

Tiranë, më 22.6 2017

Nr. identifikues 353

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Znj. EMANUELA ARIFI

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI


Lefter KOKA





REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES



LICENCË

Numri serial: LN-3547-07-2017
NUIS/NIPT: L71814020N

Subjekti: ENVIRONMENTAL AND SUSTAINABLE DEVELOPMENT OFFICE

Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Njesia Administrative Nr.8, Rruga "Ali Pashe Guca", Pallati 7 katesh, Shkalla 1, Ap.2

Kodi: III.2.A (1+2)

Kod tjetër:

Data e lëshimit: 19/07/2017

Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Specialiteti

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor dhe Vlerësimi i ndikimit në mjedis).

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nënshkrimi i sportelit:

